

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

**Numri i rastit:**

**PML.KZZ nr. 322/2016**

Nr. i rastit të Gjykatës së Apelit PAKR 456/15

Nr. i rastit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës

P 58/14

**Data:**

**19 korrik 2017**

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova (kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtare raportuese), gjyqtari i EULEX-it Arnout Louter dhe gjyqtarja e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta, të ndihmuar nga Zyrtari Ligjor i EULEX-it Timo Torkko, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurve:

1. A.D.;
2. B.D.;
3. D.D.;
4. S.D.;
5. F.D.;
6. J.D.;
7. N.D.;
8. Z.D.;
9. S.S.;
10. I.T.;

*të ngarkuar* sipas Aktakuzës PPS 88/11 të datës 8 nëntor të vitit 2013 (në tekstin e mëtejshëm “aktakuza”) me dy akuza për krime të luftës kundër popullsisë civile, në kundërshti me nenin 22 dhe 142 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare RSFJ Nr. 44 e 8 tetorit të vitit 1976) (në tekstin e mëtejshëm “LPJ”) (që aktualisht penalizohet me nenet 31 dhe 152 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “KPK”) dhe në kundërshti me nenet e përbashkëta 3 dhe 4 të Protokollit Shtesë II, të gjitha rregullave të së

drejtës ndërkombëtare që janë zbatuar në kohën e konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe në të gjitha kohët relevante për aktakuzën;

*duke vepruar sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura më:*

- 3 nëntor të vitit 2016 nga mbrojtësi A.Q. në emër të I.T.,
- 16 nëntor të vitit 2016 nga mbrojtësi R.M. në emër të S.D.,
- 17 nëntor të vitit 2016 nga mbrojtësi B.M. në emër të N.D.,
- 22 nëntor të vitit 2016 nga mbrojtësi K.O. në emër të D.D.,
- 30 nëntor të vitit 2016 nga mbrojtësi V.B. në emër të F.D.,
- 12 dhjetor të vitit 2016 nga mbrojtësi S.I. në emër të B.D.,
- 12 dhjetor të vitit 2016 nga mbrojtësi B.T. në emër të Z.D.,
- 12 dhjetor të vitit 2016 nga mbrojtësi I.A. në emër të A.D.,
- 23 dhjetor të vitit 2016 së bashku nga F.D. dhe N.D.,
- 28 dhjetor të vitit 2016 nga mbrojtësi M.S. në emër të J.D., dhe
- 23 janar të vitit 2017 nga mbrojtësi G.D.G.-S. në emër të S.S.,

të gjitha të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës të datës 27 maj të vitit 2015 në Rastin Nr. P 58/14 dhe aktgjykimi të Gjykatës së Apelit të datës 14 shtator të vitit 2016 in Rastin Nr. PAKR 456/15;

*pasi i ka shqyrtuar përgjigjet që i ka paraqitur Kryeprokurori i Shtetit;*

*pasi i ka shqyrtuar kërkesat e tjera që i ka paraqitur mbrojtësi G.D.G.-S. në emër të S.S;*

*pasi është këshilluar dhe ka votuar më 19 korrik të vitit 2017;*

*sipas neneve 418 dhe 432—441 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejshëm: KPP);*

*merr këtë:*

## AKTGJYKIM

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë që janë paraqitur nga:

- mbrojtësi A.Q. në emër të pandehurit I.T.,
- mbrojtësi R.M. në emër të pandehurit S.D.,
- mbrojtësi B.M. në emër të pandehurit N.D.,
- mbrojtësi K.O. në emër të pandehurit D.D.,
- mbrojtësi V.B. në emër të pandehurit F.D.,
- mbrojtësi S.I. në emër të pandehurit B.D.,
- mbrojtësi B.T. në emër të pandehurit Z.D.,
- mbrojtësi I.A. në emër të pandehurit A.D.,
- F.D. dhe N.D. jointly,
- mbrojtësi M.S. në emër të pandehurit J.D. dhe
- mbrojtësi G.D.G.-S. në emër të pandehurit S.S.

të gjitha kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës të datës 27 maj të vitit 2015 in Rastin Nr. P 58/14 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 14 shtator të vitit 2016 in Rastin Nr. PAKR 456/15, refuzohen si të pabazuara.

---

## HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 nëntor të vitit 2013, Aktakuza Nr. PPS 88/11 është ngritur kundër të pandehurve të lartpërmendur dhe individëve të tjerë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Akuzat kundër individëve të tjerë janë veçuar me një aktvendim të kryetarit të trupit gjykues të datës 14 prill 2014.
2. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 27 qershor të vitit 2014 dhe është përfunduar më 25 maj të vitit 2015. Ai është mbajtur para një trupi gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it D.S., si kryetar i trupit gjykues, gjyqtari i EULEX-it V.S. dhe gjyqtarja e EULEX-it A.A.-G..

3. Më 27 maj të vitit 2015, Gjykata Themelore e ka shpallur (thënë shkurt) këtë dispozitiv të aktgjykimit të saj:

- Pika 1 e aktakuzës: A.D., B.D., D.D., S.D., F.D., J.D., N.D., Z.D., S.S dhe I.T. janë shpallur fajtorë për *krime të luftës* të cilësuar sipas nenit 33 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), sipas neneve 31 dhe 152 (1), (2.1) dhe (2.2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK) dhe në kundërshti me nenin 4, paragrafin 2 (a) të Protokollit Shtesë II të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949.
- Pika 2 e aktakuzës: J.D., Z.D., S.S. dhe I.T. janë shpallur fajtorë për *krime të luftës në vazhdim* të cilësuar sipas nenit 33 (1) të Kushtetutës dhe sipas neneve 81 (1), 31, 152 (1), (2.1) dhe (2.2) të KPK-së dhe në kundërshti me nenin 4, paragrafin 2 (a) të Protokollit Shtesë II të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949.
- Të pandehurve u janë shqiptuar dënimet me burgim si vijon: A.D. – tri (3) vjet; B.D. – tri (3) vjet; D.D. – tri (3) vjet; S.D. – tri (3) vjet; F.D. – tri (3) vjet; J.D. – shtatë (7) vjet; N.D. – tri (3) vjet; Z.D. – shtatë (7) vjet; S.S. – tetë (8) vjet; dhe I.T. – shtatë (7) vjet.

4. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të datës 27 maj të vitit 2015 ankesa kanë ushtruar të gjithë të pandehurit, nëpërmjet mbrojtësve të tyre, dhe prokurori i PSRK-së.

5. Më 14 shtator të vitit 2016, Gjykata e Apelit e ka marrë aktgjykimin e saj. Ankesat e ushtruara nga prokurori i PSRK-së dhe nga mbrojtësit janë refuzuar si të pabazuara. Sipas nenit 394(1.4) të KPP-së, aktgjykimi i Gjykatës Themelore është modifikuar sipas detyrës zyrtare në dispozitivin e tij (thënë shkurt): Janë vërtetuar aktgjykimet fajësuese. Sa i përket S.S., I.T., Z.D. dhe J.D., veprat penale në pikat 1 dhe 2 të aktakuzës janë konsideruar pjesë të veprës penale në vazhdim. Dënimet me burgim që janë shqiptuar kundër tyre pastaj janë modifikuar si vijon: S.S. – shtatë (7) vjet; I.T. – gjashtë (6) vjet e gjatë (6) muaj; Z.D. – gjashtë (6) vjet; dhe J.D. – gjashtë (6) vjet.

6. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në këtë rast janë paraqitur siç është përshkruar në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi. Këto kërkesa i janë dorëzuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i cili pastaj ka paraqitur përgjigje në këto kërkesa më 27 dhjetor të vitit 2016, 5 janar të vitit 2017, 20 janar të vitit 2017 dhe 17 mars të vitit 2017.

7. Me vendimin e datës 27 prill 2017, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KGJK) ka vendosur që lënda pranë Gjykatës Supreme të gjykohet nga një trup gjykues i përbërë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe me një gjyqtar të EULEX-it si kryetar të trupit gjykues.
8. Më 15 maj të vitit 2017, mbrojtësi G.D.G.-S., në emër të pandehurit S.S., ka paraqitur kërkesë për marrjen e provave nga ana e punëtorit të EULIX-it, Kjo kërkesë i është dorëzuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i cili ka paraqitur përgjigje më 31 maj të vitit 2017.
9. Më 19 korrik të vitit 2017, mbrojtësi G.D.G.-S. e ka paraqitur, në emër të pandehurit S.S., pranë Gjykatës Supreme, një kërkesë tjetër për marrje të provave nga ana e punëtorit të EULIX-it.
10. Më 19 korrik të vitit 2017, Gjykata Supreme është këshilluar në lidhje me këto kërkesa.

## **PARASHTRESAT E PALËVE**

### **Mbrojtësi G.D.G.-S., në emër të S.S.**

11. Propozim: Në emër të S.S., mbrojtësi G.D.G.-S. i propozon Gjykatës Supreme që ta lirojë S.S. nga akuzat, t'i hedhë akuzat, t'i anulojë aktgjykimet dhe t'i kthejë lëndën Gjykatës Themelore për rigjykim. Ai kërkon nga Gjykata Supreme që ta mbajë një seancë për t'i hetuar pretendimet në lidhje me caktimin e gjyqtarës së EULEX-it A.A.-G. në trupin gjykues të Gjykatës Themelore dhe t'ia sigurojë një kopje të një raporti që pretendohet se është parashtruar nga Kryetari i Gjyqtarëve të EULEX-it. Në një kërkesë të ndarë që i është drejtuar Gjykatës Supreme dhe EULEX-it, mbrojtësi propozon që punëtori i EULEX-it të dëgjohej si dëshmitar gjatë seancës së lartpërmendur. Kërkesave u janë bashkëngjitur një letër nga punëtori i EULEX-it e datës 4 gusht 2015 si dhe disa emaila nga nëpunësit anonimë të EULEX-it të tetorit dhe nëntorit të vitit 2016. Shkeljet e pretenduara janë përmbledhur në pjesët në vijim, si vijon:

### Caktimi i gjyqtarës së EULEX-it A.A.-G. në trupin gjykues të Gjykatës Themelore:

12. Më 24 qershor të vitit 2015, pasi është shpallur aktgjykimi i Gjykatës Themelore, transmetuesi televiziv "Koha Vision" ka raportuar si vijon në lidhje me përbërjen e trupit

grykues të Grykatës Themelore: Më 29 maj të vitit 2014, kryetari i trupit grykues D.S. e ka thirrur në telefon atëherë ushtruesin e detyrës së Kryetarit të Gryqtarëve të EULEX-it G.S.. Pas kësaj thirrjeje telefonike, ai e ka dërguar një kërkesë nëpërmjet emailit, në të cilin ka kërkuar që për këtë rast të caktohej një gryqtar nga Ekipi Mobil i EULEX-it. Pas kësaj, është hartuar një urdhër për ta caktuar gryqtaren e EULEX-it, A.A.-G., për këtë rast. Ajo asokohe ka punuar për Ekipin Mobil të EULEX Mobile-it. [REDACTED]

13. Caktimi i A.A.-G. në trupin grykues të këtij rasti është bërë në kundërshti me procedurat, politikat dhe rregullat e përzgjedhjes së trupave grykues. [REDACTED]

[REDACTED] Megjithatë, palët nuk janë njoftuar asnjëherë për parregullsitë procedurale të lartpërmendura, prandaj nuk kanë ngritur kundërshtime ndaj kësaj çështjeje kur janë pyetur në fillim të shqyrtimit gryqësor. Përbërja e trupit grykues të Grykatës Themelore ka përbërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 (1.1) dhe (1.2) të KPP-së, në lidhje me nenin 39 (1.5) dhe (3) të KPP-së. Sipas nenit 384 (2.2) të KPP-së, kjo ka përbërë shkelje të të drejtave të mbrojtjes dhe ka ndikuar apo mund të ketë ndikuar në marrjen e një aktgrykimi të ligjshëm dhe të drejtë.

14. Pasi është informuar për parregullsitë e raportuara që janë përmendur më lart, mbrojtja në fillim u është drejtuar autoriteteve të EULEX-it me një kërkesë për ta hetuar këtë çështje, por punëtori i EULEX-it më vonë e ka informuar se kërkesa duhej t'i drejtohej Grykatës së Apelit. Për këtë arsye, mbrojtja e ka ngritur këtë çështje në ankesën kundër aktgrykimit të Grykatës Themelore dhe ia ka bashkëngjitur asaj letrën e punëtorit të EULEX-it. Grykata e Apelit nuk i ka hetuar këto pretendime, por, në vend të kësaj, ka konstatuar gabimisht se nuk ka pasur listë për caktimin e gryqtarëve të EULEX-it në vitin 2013 dhe se nuk ka pasur arsye për të përfunduar se trupi grykues është caktuar në kundërshti me rregullat. Këto përfundime janë të pasakta dhe të pambështetura me ndonjë provë.

15. Pasi aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është marrë më 14 shtator të vitit 2016, mbrojtja i ka marrë një numër emailash nga punonjësit anonimë të EULEX-it në tetor dhe nëntor të vitit 2016. Këta emaila i përmbajnë informatat në vijim: Gjatë procedurës ankimore, kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit nga EULEX-i e ka përmendur një bisedë që e ka pasur me punëtorin e EULEX-it. [REDACTED]

[REDACTED] Kryetari nuk ka qenë i kënaqur me këtë situatë dhe [REDACTED] EULEX-it një raport, në të cilin i ka shprehur shqetësimet e tij në lidhje me paanshmërinë e trupit gjykues. Kryetari i trupi gjykues të Gjykatës së Apelit ka thënë se mbrojtja nuk do të kërkonte nga kryetari që punëtori i EULEX-it të jepte deklaratë para gjykatës. [REDACTED]

[REDACTED] Kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit nuk ua ka shpalosur këto informata palëve në procedurë.

16. Emailave të lartpërmendur u janë bashkëngjitur kopjet e emailave që i janë dërguar dhe që i ka dërguar punëtori i EULEX-it më 29 maj të vitit 2014. Nga këto emaila është evidente se emaili përmes të cilit është kërkuar caktimi i një gjyqtari nga Ekipi Mobil është dërguar pesë minuta para se Ushtruesi i Detyrës së Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it ka kërkuar nga një nëpunës tjetër që ta hartonte një vendim për caktimin e gjyqtarës së EULEX A.A.-G. për këtë rast. Nuk ka pasur mjaft kohë për ta kontrolluar listën e gjyqtarëve, veçanërisht duke marrë parasysh se Ekipi Mobil ka pasur listë tjetër për të cilën përgjegjës ka qenë një gjyqtar tjetër. Sipas nëpunësit anonim të EULEX-it, kryetari i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit ka folur me gjyqtarin që ka qenë përgjegjës për këtë listë. Ky gjyqtar nuk kishte marrë ndonjë informatë sa i përket caktimit të gjyqtarë së EULEX-it A.A.-G. për këtë rast.

17. Mbrojtja e përsërit kërkesën e saj që Gjykata Supreme ta mbajë një seancë për të hetuar nëse trupi gjykues i Gjykatës Themelore është caktuar në mënyrë të parregullt, siç është raportuar në shtypin publik. Punëtori i EULEX-it duhet të dëgjohet si dëshmitar gjatë kësaj seance. Ndonëse ka pasur ofertë për mbrojtjen që të takohej me punëtorin e EULEX-it ai takim nuk është aranzhuar kurrë. Krahas kësaj, mbrojtjes nuk i është siguruar ndonjë kopje e raportit që pretendohet se e ka parashtruar punëtori i EULEX-it. Ky raport, nëse ekziston, është tejet i rëndësishëm për të drejtat e të pandehurit.

Procesverbal i fjalëpërfjalshëm:

18. Para se të fillonte shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën Themelore, mbrojtësi ka paraqitur propozim me shkrim, nëpërmjet të cilit ka kërkuar që të mbahej procesverbal i fjalëpërfjalshëm i procedurës. Kjo kërkesë është mohuar në ditën e parë të shqyrtimit gjyqësor. Kryetari i trupit gjykues ka vendosur që të mbështetej në daktilografistin që do ta mbante procesverbalin e gjyqimit dhe se do t'i monitoronte personalisht fjalët në ekranin e kompjuterit të tij në kohë reale për tu siguruar që procesverbali të ishte i saktë. Në të njëjtën kohë, ai ka urdhëruar që të mos lejohet audio apo video regjistrimi i dëshmimeve të dëshmitarëve të mbrojtur, sepse dikush do të mund t'ua njihte zërin. Në disa raste gjatë shqyrtimit gjyqësor, kundërshtime janë bërë ndaj dallimeve midis asaj që e ka thënë dëshmitari në gjuhën shqipe dhe asaj që është përkthyer në gjuhën angleze. Nuk ka informata se si kryetari i trupit gjykues e ka kontrolluar saktësinë e procesverbalit dhe nuk është e mundur që të kontrollohet saktësia e një procesverbali të mbajtur. Në aktgjykimin e Gjykatës Themelore theksohet se procesverbal i procedurës është mbajtur fjalë për fjalë.
19. Neni 315 i KPP-kërkon që e tërë rrjedha e shqyrtimit gjyqësor të regjistrohet në mënyrë audio ose video ose në mënyrë stenografike, përveç nëse ka shkaqe të arsyeshme për të mos bërë një gjë të tillë. Në të po ashtu kërkohet që në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor të përfshihet një kopje e audio regjistrimit të shqyrtimit gjyqësor. Megjithëkëtë, në këtë rast nuk është mbajtur ndonjë procesverbal fjalë për fjalë dhe nuk ka pasur ndonjë arsye për ta refuzuar kërkesën për të. Në gjykatore kanë qenë të pranishëm rregullisht pjesëtarë të mediave dhe të publikut. Pjesë të mëdha të gjyqimit janë incizuar nga mediat. Secili nga ai grup ka mundur t'i dëgjonte dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtur përmes videolinkut. Prandaj, arsyetimit për ta refuzuar kërkesën e mbrojtjes i ka munguar baza ligjore dhe logjike.
20. Një procesverbal fjalë për fjalë i tërësisë së procedurës ka qenë mënyra e vetme për tu siguruar që procedura të regjistrohej saktë për të ardhmen. Si rezultat i mungesës së një procesverbali të duhur, gjykatat e shkallëve më të larta nuk kanë ndonjë procesverbal fjalë për fjalë. Mungesa e një procesverbali të plotë dhe të saktë po ashtu ka ndikuar negativisht në aftësinë e gjyqtarëve për ta vërtetuar kredibilitetin, besueshmërinë dhe vlerën provuese të dëshmimeve në mënyrë të plotë dhe të saktë. Një procesverbal fjalë për fjalë i tërësisë së procedurës ka qenë esencial për një shqyrtim të drejtë dhe të duhur të



provave. Krahas kësaj, kryetari i trupit gjykues i ka shkelur detyrat etike si gjyqtar duke e monitoruar personalisht procesverbalin dhe duke e korrigjuar atë, meqë kësisoj ai e ka shkelur vijën midis rolit të tij si konstatues i fakteve dhe dikujt që merr pjesë aktive në krijimin e procesverbalit. Prandaj, ai është përfshirë në një sjellje që e cenon besimin në integritetin e gjyqësorit. Nuk është e mundur që një gjyqtar t'i kryejë detyrat e tij/të saj si gjyqtar/e nëse nga ai/ajo kërkohet edhe që ta monitorojë saktësinë e procesverbalit.

21. Në shkallën e dytë, Gjykata e Apelit gabimisht ka konstatuar se Gjykata Themelore ka pasur arsye të vlefshme për të refuzuar që ta sigurojë ndonjë audio apo video regjistrim apo procesverbal stenografik fjalë për fjalë të gjykimit, për shkak të nevojës për t'i mbrojtur dëshmitarët. Veç kësaj, Gjykata e Apelit gabimisht ka konstatuar se kryetari i trupit gjykues ka qenë në gjendje të garantonte se deklaratat janë regjistruar në mënyrë korrekte. Kryetari i trupit gjykues nuk e flet rrjedhshëm gjuhën shqipe, prandaj nuk ka mundur të garantojë se deklaratat e dëshmitarëve janë përkthyer apo regjistruar saktë.
22. Mosmbajtja e procesverbalit të procedurës fjalë për fjalë ia ka mohuar të pandehurit të drejtën në gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, dënimet duhet të prapësohen dhe, sipas parimit ligjor të *ne bis in idem*, të gjitha akuzat duhet të hidhen poshtë. Si minimum, i pandehuri ka të drejtë në gjykim të ri, në të cilin mbahet procesverbal i duhur fjalë për fjalë.

Dëshmitarët armiqësorë dhe përdorimi i deklaratave të marra në procedurë paraprake:

23. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, një numër dëshmitarësh kanë deklaruar se deklaratat që u janë marrë në procedurë paraprake nuk kanë qenë të sakta. Në mesin e këtyre dëshmitarëve kanë qenë dëshmitari A, dëshmitari K, dëshmitari B dhe Dr. B.G.. Të metat e pretenduara kanë qenë sa nga ta është kërkuar që të nënshkruanin deklarata që nuk ishin përkthyer dhe që nuk u ishin lexuar dëshmitarëve në gjuhën e tyre, deklarata që kanë përmbajtur informata që kurrë nuk i janë siguruar prokurorisë apo informata të pasakta si dhe deklarata që janë ndryshuar më pas. Gjykata Themelore nuk i ka hetuar këto të meta gjatë shqyrtimit gjyqësor. Për më tepër, mospërputhjet midis asaj që dëshmitarët kanë deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe asaj që pretendohet se kanë thënë në deklaratat që u janë marrë në procedurë paraprake janë përdorur si bazë për t'i shpallur disa nga dëshmitarët si “dëshmitarë armiqësorë”, koncept ky që e ka ndryshuar dramatikisht procedurën e marrjes në pyetje të këtyre dëshmitarëve. Moshetimi i saktësisë së

deklaratave që janë marrë në procedurë paraprake nga ana e Gjykatës Themelore ka ndikuar negativisht në të drejtën e të pandehurve në gjykim të drejtë.

24. Çështjet e lartpërmendura janë ngritur në ankesën e ushtruar pranë Gjykatës së Apelit. Pasi është ushtruar ankesa, njëri nga prokurorët e EULEX-it që i ka përgatitur deklaratat që janë marrë në procedurë paraprake në këtë rast ka dëshmuar në çështjen penale kundër të pandehurve M.Z. dhe R.R.. Kjo dëshmi i është dorëzuar si provë e porsazbuluar Gjykatës së Apelit, meqë në të është përshkruar mënyra në të cilën janë përmbledhur deklaratat e dëshmitarëve nga dy prokurorët e EULEX-it, të cilët i kanë përgatitur një numër deklaratash që janë marrë në procedurë paraprake në këtë rast. Shkurtimisht, prokurori i EULEX-it ka dëshmuar se deklaratat me shkrim që janë marrë në procedurë paraprake nuk kanë qenë paraqitje e fjalëpërfjalshme e asaj që është thënë gjatë deklaratave që janë marrë në procedurë paraprake, por, përkundrazi, kanë qenë përmbledhje e atyre pjesëve që prokuroria i ka konsideruar relevante. Dëshmia e prokurorit të EULEX-it përbën provë rrethore në këtë rast, meqë i konfirmon shpjegimet e dëshmitarëve se procesverbalet me shkrim të deklaratave që u janë marrë në procedurë paraprake kanë qenë të paplota apo përmbledhje e pasaktë e asaj që është thënë.

25. Gjykata e Apelit nuk i ka trajtuar drejt çështjet e lartpërmendura në aktgjykimin e saj. Në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit theksohet gabimisht se mbrojtja e konteston pranueshmërinë e deklaratave që janë marrë në procedurë paraprake. Kjo nuk është e saktë, meqë kjo çështje ligjore nuk ka të bëjë me pranueshmërinë e deklaratave. Çështja ligjore që është ngritur në ankesë ka qenë se disa nga deklaratat e dëshmitarëve që janë marrë në procedurë paraprake janë aq të shtrembëruara, aq shumë të redaktuara dhe aq keq të përmbledhura sa që nuk mund të përdoren për asnjë qëllim në gjykim. Për shkak të këtyre të metave – si minimum – trupi gjykues është dashur t'i bënte disa pyetje, meqë disa dëshmitarë kanë dëshmuar se deklaratat që u janë marrë në procedurë paraprake kanë qenë dramatisht të pasakta. Meqë gjykatat i kanë përdorur këto deklarata në një masë të këtyllë, akuzat duhet të hidhen. Së paku, i pandehuri ka të drejtë në gjykim të ri.

#### Të metat e shqyrtimit të Gjykatës së Apelit:

26. Rezultati i aktgjyimit të Gjykatës Themelore ka qenë rezultat i dështimit të trupit gjykues për t'i zbatuar standardet e duhura ligjore për vlerësimin e provave apo të barrës

së provës. Kërkesa ligjore e provës tej dyshimit të arsyeshëm nuk është zbatuar në këtë rast. Gjykata Themelore nuk i ka shqyrtuar provat si tërësi dhe, në vend të kësaj, është mbështetur vetëm në disa nga to. Nganjëherë, barra e provës është bartur në mënyrë të paligjshme tek i akuzuari. Nuk është supozuar pafajësia e të pandehurit sipas parimit ligjor të *in dubio pro reo*. Të gjitha këto argumente janë paraqitur në ankesë, por nuk janë trajtuar drejt në shkallën e dytë. Kështu, Gjykata e Apelit nuk e ka zbatuar standardin e duhur gjatë shqyrtimit të pretendimeve që janë paraqitur në ankesë.

27. Dënimi i të pandehurit është bazuar vetëm në dëshminë e dëshmitarit A, dëshmia e të cilit jo vetëm që është kundërshtuar nga pothuaj të gjithë dëshmitarët e tjerë të pavarur që kanë dëshmuar për çështjet e ndërlidhura, por ka qenë edhe kundërtënëse në vetvete, jo konsistente dhe i rrejshme. Gjykata e Apelit nuk i ka trajtuar dhe nuk i ka vlerësuar drejt provat në vijim, të cilat e kanë kundërshtuar, cenuar, përgënjeshtuar dhe kontestuar seriozisht kredibilitetin dhe besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit A:

- *Dr. C.B.*: Gjykata e Apelit nuk e ka trajtuar dhe vlerësuar drejt dëshminë e Dr. C.B. kur ka konstatuar gabimisht se deklarata e dëshmitarit A nuk është mbështetur nga kjo deklaratë. Kjo dëshmi në fakt ka ngritur dyshime serioze sa i përket kredibilitetit dhe besueshmërisë së dëshmitarit A, meqë ka rënë ndesh me deklaratën e tij në lidhje me lëndimet e pretenduara fizike që janë shkaktuar nga keqtrajtimi i pretenduar. Gjykata e Apelit, sipas parimit ligjor *in dubio pro reo*, ka qenë ligjërisht e obliguar që ta marrë këtë në konsideratë dhe ta lirojë të pandehurin.
- *Dr. G.H.*: Gjykata e Apelit nuk e ka trajtuar dhe vlerësuar drejt dëshminë e Dr. G.H. në lidhje me gjendjen mendore të dëshmitarit A. Në vend që të mbështetej në këtë dëshmi, Gjykata Themelore e ka bazuar vlerësimin e saj për kredibilitetin dhe besueshmërinë e dëshmitarit A në vlerësimin psikologjik të saj për dëshminë e tij dhe ka theksuar se dëshmia e Dr. G.H. nuk ka qenë bindëse, meqë “nuk ka provuar” se aftësia e dëshmitarit A për të dhënë dëshmi të besueshme ka qenë e kufizuar. Në këtë konstatim nuk jep ndonjë përgjigje se a i ka munguar dëshmitarit A kredibiliteti apo besueshmëria për ngjarjet e kaluara apo jo dhe, përveç kësaj, aty barra e provës vihet në mënyrë të paligjshme mbi të pandehurin. Këto çështje janë ngritur në ankesë, por nuk janë trajtuar drejt nga Gjykata e

Apelit. Në vend të kësaj, Gjykata e Apelit ka konstatuar gabimisht se prova mjekësore e vetme e një sëmundjeje ka qenë e vitit 2003, se diagnoza ka qenë e natyrës akute dhe se dëshmitari A nuk ka shfaqur ndonjë simptomë të çrregullimin mendor gjatë dëshmisë së tij.

28. Gjykata e Apelit nuk e ka trajtuar dhe vlerësuar drejt mungesën e provave për ta mbështetur identifikimin e S.S. si njëri nga kryerësit. Gjykata e Apelit e ka përsëritur vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike të Gjykatës Themelore kur ka konkluduar se është provuar se i pandehuri ka qenë njëri nga kryerësit, ndonëse nuk ka pasur ndonjë provë për ta mbështetur një konkludim të tillë. Gjykata e Apelit së paku duhej ta kishte kundërshtuar identifikimin e dëshmitarit A me ndonjë lloj testimi të besueshmërisë së tij dhe saktësisë të deklaratës së tij. Dështimi për ta bërë këtë përbën shkelje të ligjit që nuk është trajtuar drejt nga Gjykata e Apelit.
29. Gjykata e Apelit nuk i ka vlerësuar dhe shqyrtuar provat si tërësi. Standardet ligjore të zbatueshme për vlerësimin e provave nuk janë trajtuar apo shqyrtuar. Në kundërshti me parimin ligjor të *in dubio pro reo*, Gjykata e Apelit nuk i ka shqyrtuar dhe trajtuar drejt provat që e kanë kundërshtuar dëshmitarin A, siç janë dëshmitë e dëshmitarit B, Dr. F.B., Dr. B.G. dhe R.S., si dhe aplikacioni për status të veteranit që e ka dorëzuar dëshmitari A. Dëshmia e dëshmitarit B ka rënë ndesh me deklaratën e dëshmitarit A sa u përket disa fakteve vendimtare qenësore. Gjykata e Apelit e ka miratuar në mënyrë të pasaktë vërtetimin e Gjykatës Themelore se dëshmitari B ka qenë “dukshëm i frikësuar për ta thënë të vërtetën”. Për faktin se nuk ka pasur ndonjë video apo audio regjistrim të asaj dëshmie, Gjykata e Apelit nuk ka pasur baza për ta nxjerrë këtë përfundim.
30. Gjykata e Apelit nuk e ka vlerësuar dhe trajtuar drejt kredibilitetin dhe besueshmërinë e dëshmitarit A apo dëshmitarit K. Këto dëshmi kanë qenë vetë jo konsistente dhe thelbësisht kundërthënëse në shumë pika. Për disa çështje të rëndësishme, deklarata e dëshmitarit A është kundërshtuar drejtpërsëdrejti nga provat e tjera, nuk është mbështetur me ndonjë provë ose ka qenë jologjike apo krejtësisht iluzore në vetvete. Megjithatë, të gjitha pjesët e deklaratës së dëshmitarit A që kanë treguar fuqishëm se ai nuk është kredibil dhe i besueshëm nuk janë përmendur në aktgjykimet e kundërshtuara. Gjykata e Apelit ka qenë e obliguar t’i trajtojë këto pjesë me përfundimin se dëshmia e dëshmitarit

A ka qenë, për të thënë më së paku, e pabesueshme dhe se është parë qartë se ajo nuk e ka plotësuar standardin e të provuarit tej dyshimit të arsyeshëm.

31. Të metat e lartpërmendura përbëjnë shkelje të neneve 7 (1) dhe 370 (7) të KPP-së. Kjo ia ka mohuar të pandehurit gjykimin e drejtë. Prandaj, dënimet që i janë shqiptuar atij duhet të prapësohen dhe të hidhen poshtë. Ai së paku ka të drejtë në gjykim të ri.

Kërkesat për nxjerrje të provave të reja:

32. Sipas një kërkesë të ndarë të datës 10 maj të vitit 2017 të paraqitur nga mbrojtësi i S.S., punëtori i EULEX-it, duhet të dëgjohet si dëshmitar gjatë seancës hetimore. Provat e punëtorit të EULEX-it, ndërlidhen drejtpërsëdrejti me parregullsitë e pretenduara gjyqësore gjatë përzgjedhjes dhe caktimit të përbërjes së trupit gjykues. Punëtori i EULEX-it ka informata dhe mund të japë prova të drejtpërdrejta për këtë çështje, posaçërisht për protokollin dhe procesin që përdoret për caktimin e përbërjes së trupave gjykues. Prandaj, dëshmia potenciale e tij është tejet relevante dhe esenciale për zgjidhjen e drejtë të procedurës si dhe integritetin e sistemit gjyqësor në Kosovë.
33. Sipas kërkesës që është paraqitur pranë Gjykatës Supreme më 19 korrik të vitit 2017 nga mbrojtësi i S.S., mbrojtja e përsërit kërkesën e mëparshme të saj që Gjykata Supreme ta lejojë nxjerrjen e provave të reja.

**F.D. dhe N.D.**

34. Propozim: Në një kërkesë të përbashkët, F.D. dhe N.D. i propozojnë Gjykatës Supreme që t'i lirojë nga akuza, t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe që lëndën t'ia kthejë Gjykatës Themelore për rigjykim. Ata kërkojnë nga Gjykata Supreme që të urdhërojë që zbatimi i aktgjykimeve të shtyhet derisa kërkesa e tyre të shqyrtohet përfundimisht. Ata theksojnë:

35. Në kundërshti me nenin 5 KPP, e drejta e tyre në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme është shkelur. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk është marrë brenda afatit ligjor. Në kundërshti me nenin 314 KPP, është dashur më shumë se një vit e pesë muaj nga shpallja e aktgjykimit të Gjykatës Themelore që Gjykata e Apelit ta merrte aktgjykimin e saj. Vonesën e kanë shkaktuar vetëm prokuroria dhe gjykatat. Për më tepër, asnjëra gjykatë nuk ka dhënë ndonjë shpjegim për vonesën.

36. Në kundërshti me nenet 2 dhe 3 të KPP-së, gjykatat e kanë paragjykuar këtë rast dhe nuk kanë supozuar se të pandehurit janë të pafajshëm as në fillim, as gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor. Vërtetimi i gjendjes faktike është bazuar në një vlerësim të njëanshëm dhe të anuar të provave. Vetëm provat që e kanë mbështetur akuzën janë konsideruar të besueshme dhe kredibile. Dëshmitari A është konsideruar gabimisht i besueshëm dhe kredibil, edhe pse ka qenë evidente se ka dhënë deklaratë të rrejshme për disa çështje të rëndësishme. Për më tepër, është konkluduar gabimisht se dëshmia e tij është mbështetur nga deklaratat e dëshmitarëve të tjerë. Duke i shpallur disa nga këta dëshmitarë si armiqësorë, vetëm disa pjesë të përzgjedhura të dëshmive të tyre janë marrë parasys. Pjesët e deklaratave të tyre që kanë qenë në dobi të të pandehurve janë shpallur të pabesueshme vazhdimisht. Prandaj, të dyja gjykatat e kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike në dëm të të pandehurve. Sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore është i paqartë dhe kundërrthënës. Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit bie ndesh me arsyetimin e tij.
37. Gjatë tërë procedurës, marrja në pyetje e dëshmitarëve është bërë në kundërshti me ligjin. Gjatë hetimit, dëshmitarët janë marrë në pyetje shumë herë, derisa në ta është ndikuar që t'i japin disa deklarata përmes kërcënimeve dhe premtimeve. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, disa nga dëshmitarët janë shpallur si “dëshmitarë armiqësorë” në kundërshti me dispozitat e zbatueshme të procedurës penale. Kësisoj, prokurorit i është lejuar që dëshmitarëve t'u bëjë pyetje sugjestive vazhdimisht, në kundërshti me ligjin. Nganjëherë, këto pyetje janë formuluar me ndihmën e kryetarit të trupit gjykues. Kjo e ka shkelur parimin e barazisë së palëve, meqë ka shkuar vazhdimisht në favor të prokurorisë.
38. Trupi gjykues i Gjykatës Themelore është përbërë në kundërshti me ligjin, meqë ai është përbërë vetëm nga gjyqtarë të EULEX-it. Ky pretendim mbështetet nga fakti se trupi gjykues i Gjykatës së Apelit është përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor. Krahas kësaj, njëri nga anëtarët e trupit gjykues është emëruar në mënyrë të paligjshme për këtë rast, sipas informatave që janë bërë të ditura për publikun pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Emërimi i paligjshëm i njërit prej anëtarëve të trupit gjykues tregon se Gjykata Themelore e ka paragjykuar këtë rast.

39. Në kundërshti me të drejtën penale, gjykatat i kanë shpallur të pandehurit fajtorë për veprat penale sipas një ligji që ka qenë në fuqi në kohën kur pretendohet se janë kryer veprat penale dhe që nuk është në dobi të të pandehurit. Sa i përket së drejtës materiale penale të zbatueshme, aktgjykimet e kundërshtuara kanë të pakuptueshme dhe kundërthënëse.

#### **Mbrojtësi V.B. në emër të F.D.**

40. Propozim: Në emër të F.D., mbrojtësi V.B. i propozon Gjykatës Supreme që t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe që lëndën t'ia kthejë Gjykatës Themelore për rigjykim. Ai thekson:

41. Në kundërshti esenciale me dispozitat e procedurës penale, gjykatat nuk e kanë gjykuar plotësisht substancën e akuzave. Aktgjykimet e kundërshtuara janë të pakuptueshme dhe kundërthënëse. Në arsyetim nuk trajtohen provat vendimtare dhe ai është në kundërshti me shkresat e lëndës. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore konsiston në disa kundërthënie, dhe atë si vijon:

- Në paragrafin 80, Gjykata Themelore u referohet “të gjithë të akuzuarve”, por nuk saktëson se cili nga të pandehurit i ka rrahur dëshmitarët A dhe B. Krahas kësaj, dëshmitari B kur nuk e ka përmendur se është rrahur nga F.D..
- Në paragrafin 86, Gjykata Themelore përfundon se F.D. e ka pësuar një *lëndim* në krah, i cili është shkaktuar nga një granatë dore, dhe se atij i është rekomanduar që të mos e përdorte krahun e tij *të plagosur* për tre muaj. Termat “lëndim” dhe “plagë” janë krejtësisht të ndryshëm. Për më tepër, nuk theksohet se në cilat prova është bazuar Gjykata Themelore kur ka përfunduar se lëndimi është shkaktuar nga një granatë dore. Në këtë aspekt, Gjykata Themelore i ka tejkaluar deklaratat që janë dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor.
- Në paragrafin 122, Gjykata Themelore thekson se lëndimi në krah nuk e ka penguar F.D. që ta rrahë dëshmitarin A dhe po ashtu se dëshmitari A nuk ka dhënë ndonjë hollësi përkitazi me aktin që e ka kryer F.D.. Kjo deklaratë bie ndesh me arsyetimin në paragrafin 80, meqë dëshmitari B nuk përmendet dhe meqë në të theksohet qartë se dëshmitari A nuk ka dhënë ndonjë përshkrim të ndonjë akti të kryer nga F.D..

42. Në kundërshti me nenin 262 KPP, dënimi i F.D. bazohet vetëm ose në masë vendimtare në dëshminë e dëshmitarit A. Gjykatat e kanë shkelur parimin ligjor të *in dubio pro reo* sipas nenit 7 të KPP-së kur e kanë vlerësuar këtë deklaratë. Meqë i pandehuri nuk i ka kryer veprat penale të pretenduara për të cilat është dënuar, nuk duhej të ishte shqiptuar kurrfarë dënimi.

43. Në kundërshti me Ligjin për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, trupi gjykues i Gjykatës Themelore është përbërë vetëm nga gjyqtarë të EULEX-it. Sipas këtij ligji, trupi gjykues duhej të ishte përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor. Krahas kësaj, njëri nga anëtarët e trupit gjykues është emëruar në kundërshti me rregullat e brendshme të EULEX-it. Sipas këtyre rregullave të brendshme, vetëm gjyqtarët e EULEX-it që shërbejnë në Gjykatën Themelore në Prishtinë mund të ishin emëruar si gjyqtarë zëvendësues për rastet e Gjykatës Themelore të Mitrovicës.

#### **Mbrojtësi B.M. në emër të N.D.**

44. Propozim: Në emër të N.D., mbrojtësi B.M. i propozon Gjykatës Supreme që ta lirojë të pandehurin nga akuzat dhe të urdhërojë që zbatimi i aktgjykimeve të shtyhet. Ai thekson:

45. Në kundërshti me ligjin penal, gjykatat i kanë shpallur të pandehurit fajtorë për vepra penale të kryera në bashkëkryerje pa ofruar ndonjë argument apo provë për t'i mbështetur elementet që janë përcaktuar në nenin 31 të KPK-së. Sa i përket N.D., shihet qartë se këto elemente penale nuk janë plotësuar për faktin se dëshmitari A nuk ka thënë se N.D. ka kryer ndonjë veprim të paligjshëm kundër tij.

46. Në kundërshti esenciale me dispozitat e procedurës penale sipas nenit 384 (1.1) dhe (1.2) të KPP-së, përbërja e trupit gjykues të Gjykatës Themelore nuk ka qenë në përputhje me Ligjin për Kompetencat, sepse trupi gjykues është përbërë vetëm nga gjyqtarë të EULEX-it. Sipas Ligjit për Kompetencat, trupi gjykues duhej të ishte përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor.

47. Në kundërshti esenciale me dispozitat e procedurës penale sipas nenit 384 (1.12) të KPP-së, aktgjykimet nuk janë hartuar në përputhje me nenin 370 të KPP-së. Dënimi është bazuar vetëm në dëshminë e dëshmitarit A. Kjo përbën shkelje të neneve 262 dhe 361 të



KPP-së, meqë i pandehuri nuk mund të shpallet fajtor vetëm në bazë të dëshmisë së një dëshmitari.

48. Sipas nenit 384 (2) të KPP-së, prokuroria dhe gjykatat e kanë shkelur ligjin në disa raste, sipas mbrojtësit. Këto shkelje janë saktësuar në fjalët përfundimtare para gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë dhe do të përsëriten. Kur të vendosë për këtë kërkesë, Gjykata Supreme duhet ta analizojë dhe vlerësojë me kujdes përmbajtjen e të gjitha shkresave të lëndës.

#### **Mbrojtësi M.S. në emër të J.D.**

49. Propozim: Mbrojtësi i J.D. i propozon Gjykatës Supreme që ta lirojë të pandehurin nga akuzat ose t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën t'ia kthejë Gjykatës Themelore për rigjykim. Krahas kësaj, ai kërkon nga Gjykata Supreme që të pandehurit t'ia heqë paraburgimin. Ai thekson:

#### Përbërja e trupit gjykues të Gjykatës Themelore:

50. Në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 (1.1) të KPP-së, trupi gjykues i Gjykatës Themelore është përbërë vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it. Prandaj, trupi gjykues është përbërë në shkelje të Ligjit mbi kompetencat sipas të cilit trupi gjykues asnjëherë nuk mund të përbëhet vetëm nga gjyqtarët e EULEX-it. Është e parëndësishme për këtë çështje se çfarë është rënë dakord në mes të Shefave të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës pasi që marrëveshja nuk është ligjërish e detyrueshme. Nga arsyetimi i aktgjyimit të Gjykatës Themelore në paragrafët 12—14 është e qartë se Gjykata Themelore ka qenë në dijeni të kësaj shkelje pasi që i referohet “praktikës së krijuar”, jo ligjit. Më tutje, arsyetimi është i pakuptueshëm pasi që Gjykata Themelore nuk ka sqaruar se pse pjesëmarrja e një gjyqtari vendor do të pamundësonte të drejtën në gjykim, posaçërisht duke pasur parasysh se të gjithë të pandehurit dhe të gjithë avokatët mbrojtës përveç njërit janë me kombësi shqiptare.
51. Gjykata e Apelit nuk ka arritur që të adresojë siç duhet çështjet që kanë të bëjnë me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore. Në vend të kësaj, Gjykata e Apelit ka krijuar konfuzion të mëtutjeshëm në njërën anë duke u pajtuar me Gjykatën Themelore lidhur me përbërjen e saj dhe në anën tjetër duke theksuar se kolegji i Gjykatës së Apelit në përputhje me Ligjin mbi kompetencat duhet të përbëhet nga dy gjyqtarë të EULEX-it

dhe një gjyqtari vendor. Më tutje, Gjykata e Apelit ka dështuar që të vlerësojë dhe adresojë tërësisht shqetësimet e ngritura në ankesa lidhur me caktimin e një anëtari në trupin gjykues të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit është dashur të paraqes një arsyetim më të detajuar në lidhje me atë se pse ky anëtar i trupit gjykues është caktuar në këtë lëndë.

Mangësitë e aktgjytimeve të kundërshtuara:

52. Në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 (1.12) të KPP-së, aktgjykimet e kundërshtuara nuk i përmbushin kushtet e përcaktuara me nenin 370 të KPP-së. Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore është i pakuptueshëm dhe i mungon përshkrimi i qartë faktik i veprimeve kriminale për të cilat të secili i pandehur është shpallur fajtor, periudhën kohore lidhur me këto veprime dhe pasojat në të cilat shpijnë, si dhe një referencë të qartë në dispozitat e ligjit në fuqi. Sa i përket dispozitave ligjore, dispozitivi është kundërtëhënës me arsyetimin pasi që ky i fundit i referohet Kodit Penal të vitit 2004 kurse dispozitivi i referohet Kodit Penal të vitit 2012.
53. Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është i pakuptueshëm pasi që ankesat janë refuzuar, por aktgjykimi i kundërshtuar është ndryshuar. Gjithashtu, është në kundërshtim me arsyetimin në faqen 34 të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Nga kjo pjesë e arsyetimit, është e qartë se Gjykata e Apelit nuk ka konfirmuar që J.D. e ka urdhëruar Dëshmitarin A dhe Dëshmitarin B që të rrahin njëri-tjetrin ose që ai e ka rrahur Dëshmitarin A me një shkop prej druri. Sidoqoftë, në dispozitiv, këto veprime konsiderohen si vepra penale që përbëjnë trajtim çnjerëzor dhe degradues ndaj Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B. Për më tepër, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk i adreson pretendimet e ngritura në ankesë.

Akuza:

54. Në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 (1.10) të KPP-së, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar te jkallon akuzën. Krahasimi i përshkrimit të veprave siç janë përshkruar në aktakuzë dhe përshkrimi i dhënë në dispozitivin e aktgjytimeve të kundërshtuar tregon se gjykatat në mënyrë thelbësore kanë ndryshuar identitetin e aktakuzës.

Dëshmitarët armiqësorë:

55. Deklaratat e dëshmitarëve janë marrë në shkelje të ligjit gjatë gjithë procedurës. Gjatë hetimit, Dëshmitari A dhe Dëshmitari B janë dëgjuar disa herë dhe këto deklarata asnjëherë nuk i janë paraqitur mbrojtjes. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, disa nga dëshmitarët në mënyrë të kundërligjshme janë deklaruar si "dëshmitarë armiqësorë" në shkelje të KPP-së. Si pasojë e këtyre deklaramëve të kundërligjshme, prokurorit i është lejuar që t'iu parashtrojë pyetje drejtuese dëshmitarëve në kundërshtim me ligjin. Në disa raste, kryetari i trupit gjykues e ka ndihmuar prokurorin që t'i formulojë këto pyetje. Kryetari i trupit gjykues në këtë mënyrë ka vepruar krejtësisht ndryshe nga ajo që është deklaruar gabimisht në paragrafin 35 të aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Kjo sjellje ka shkelur barazinë mes palëve në procedurë pasi që ka qenë vetëm në dobi të prokurorit. Më tutje, kjo ka kontribuar në një vërtetim faktik të pasaktë pasi që dëshmitarët ishin vënë nën presion.

Prezumimi i pafajësisë dhe vërtetimi faktik:

56. Aktgjykimet e kundërshtuara janë kundërtënëse pasi që në njërin anë deklarojnë se dëshmitë e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit K përmbajnë mangësi, siç është mungesa e strukturës dhe zbrazësi, ndërsa në anën tjetër gjykata e ka bazuar vërtetimin faktik në këto dëshmi. Të dy gjykatat gabimisht kanë arritur në përfundim se Dëshmitari A është dëshmitar i besueshëm dhe kredibil përkundër deklaratës së tij dhe provave të tjera të cilat në mënyrë të qartë e vërtetojnë të kundërtën. Gjykatat nuk kanë paraqitur arsye të mjaftueshme se pse nuk janë marrë parasysh deklaratat e dëshmitarëve të tjerë. Gjykatat kanë shkelur nenin 7 të KPP-së kur nuk kanë ekzaminuar dhe nuk kanë marrë parasysh provat të cilat vërtetojnë se Dëshmitari A nuk është i besueshëm, siç është deklarata e Dr. C.B. lidhur me lëndimet e tij, deklarata e Dr. G.H. lidhur me shëndetin e tij mendor dhe aplikimin e tij për statusin e veteranit të UÇK-së. Në shkelje të parimit ligjor të prezumimit të pafajësisë të përcaktuar në nenin 3 të KPP-së, vërtetimi faktik është bërë në mënyrë të njëanshme dhe të pjesshme.

Parimi i ligjshmërisë:

57. Gjykata Themelore ka shkelur parimin e ligjshmërisë kur ka bazuar dënimin në ligjin i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur vepra penale e pretenduar. Këto shqetësime janë ngritur në ankesë por nuk janë adresuar në mënyrë korrekte nga Gjykata e Apelit. Në vend të kësaj, Gjykata e Apelit gabimisht ka arritur në përfundim se neni 152 i KPK-së është i zbatueshëm si ligji më i favorshëm dhe ka dhënë arsyetim të

pakuptueshëm për këtë përfundim. Zbatimi i dispozitës ligjore e cila nuk ka qenë në fuqi në kohën e veprave të pretenduara penale ka shkelur parimin e ligjshmërisë, ligjin penal dhe praktikën gjyqësore të krijuar në Kosovë.

Shqiptimi i dënimit:

58. Gjykatat nuk kanë paraqitur arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me dënimin e shqiptuar. Përshkrimi faktik i veprave penale nuk mund të konsiderohet kurrë si një rrethanë rënduese. Si faktor lehtësues, Gjykata e Apelit ka marrë parasysh vetëm sjelljen e sinqertë të të pandehurve, por nuk ka marrë parasysh faktorët e tjerë lehtësues të zbatueshëm, siç është fakti se i pandehuri nuk ka dosje penale, situatën e tij familjare dhe sjelljen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor.

**Avokati mbrojtës I.A. në emër të A.D.**

59. Propozim: Avokati mbrojtës i A.D. i propozon Gjykatës Supreme që t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në Gjykatën Themelore. Ai thekson:

60. Në shkelje të ligjit penal, A.D. është shpallur fajtor për akuzat edhe pse elementet kriminale nuk janë provuar apo vërtetuar. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh se i pandehuri nuk ka pasur për qëllim që ta kryejë ndonjë krim kundër popullit të tij. Siç është shtjelluar në hollësi në ankesën e aktgjyimit të Gjykatës Themelore, nuk ka pasur asnjë provë e cila ka vërtetuar ndonjë akt të të pandehurit.

61. Në shkelje të procedurës penale, gjykatat gabimisht kanë marrë rolin e ekspertit kur kanë konstatuar se deklarata e Dëshmitarit A është e besueshme përkundër deklaratës së ekspertit Dr. G.H. e cila ka vërtetuar të kundërtën. Përkundër kësaj deklarate të dy gjykatat kanë gjetur se Dëshmitari A është i besueshëm. Sidoqoftë, nuk ka qenë nën autoritetin e gjykatës që të vendos mbi këtë çështje.

**Avokati mbrojtës S.I. në emër të B.D.**

62. Propozim: Avokati mbrojtës i B.D. i propozon Gjykatës Supreme që t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në Gjykatën Themelore. Ai thekson:

63. Në shkelje të ligjit penal, B.D. është shpallur fajtor për akuzat edhe pse elementet kriminale nuk janë provuar apo vërtetuar. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh se i pandehuri nuk ka pasur për qëllim që ta kryejë ndonjë krim kundër popullit të tij. Siç është shtjelluar në hollësi në ankesën e aktgjykimit të Gjykatës Themelore, nuk ka pasur asnjë provë e cila ka vërtetuar ndonjë akt të pandehurit.
64. Në shkelje të procedurës penale, gjykatat gabimisht kanë marrë rolin e ekspertit kur kanë konstatuar se deklarata e Dëshmitarit A është e besueshme përkundër deklaratës së ekspertit Dr. G.H. e cila ka vërtetuar të kundërtën. Përkundër kësaj deklarate të dy gjykatat kanë gjetur se Dëshmitari A është i besueshëm. Sidoqoftë, nuk ka qenë nën autoritetin e gjykatës që të vendos mbi këtë çështje.

**Avokati mbrojtës B.T. në emër të Z.D.**

65. Propozim: Avokati mbrojtës i Z.D. i propozon Gjykatës Supreme që t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në Gjykatën Themelore. Ai kërkon nga Gjykata Supreme që *mutatis mutandis* në përputhje me nenin 389 (5) të KPP-së, ta ndërpresë masën e paraburgimit kundër të pandehurit dhe menjëherë ta lirojë atë. Më tutje, ai kërkon nga Gjykata Supreme që ta ftojë punëtorin e EULEX –it për të dëshmuar lidhur me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore. Pretendimet e paraqitura në ankesë janë përmbledhur si në vijim:
66. Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore është i pakuptueshëm në lidhje me dispozitat e zbatueshme ligjore dhe vendimin mbi dënimin. Zbatimi i dispozitave të ndryshme ligjore në të njëjtën kohë nuk është në përputhje me ligjin. Dispozitivi nuk e specifikon se kur janë kryer veprat e pretenduara penale, apo veprimet konkrete të cilat janë kryer nga secili i pandehur. Dispozitivi thekson se të pandehurit me dashje kanë kryer dhunë, trajtim mizor, torturë dhe trajtim poshtërues dhe degradues kundër Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit B por këto veprime nuk janë përmendur në asnjërën nga dispozitat ligjore të zbatuara. Më tutje, aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban sasi të mëdha të informacioneve të panevojshme.
67. Gjykata e Apelit ka dështuar që të adresojë plotësisht dhe veçmas të gjitha pretendimet e ngritura në ankesa. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk i ka trajtuar tërësisht çështjet në vijim: (1) mangësitë e aktgjykimit të Gjykatës Themelore të përmendura më lart, (2) pse

procedura është ndarë në dy raste të veçanta, (3) pretendimet lidhur me caktimin e gjyqtarës së EULEX-it A.A.-G. në lëndë, (4) pretendimet lidhur me konceptin e dëshmitarëve armiqësorë, dhe (5) pretendimet lidhur me bazën e fajësisë në përputhje me nenin 262 të KPP-së. Gjetjet e Gjykatës së Apelit në lidhje me këto çështje janë kontradiktore me faktet e rastit, nuk janë të mbështetura nga ndonjë fakt/provë, ose janë tërësisht të pakuptueshme.

68. Në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 (1.10) të KPP-së, dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore ka tejkaluar akuzën sipas nenit 360 të KPP-së. Kjo shkelje është dashur të shqyrtohet sipas detyrës zyrtare nga Gjykata e Apelit.
69. Trupi gjykues i Gjykatës Themelore është përbërë në shkelje të rregullave të brendshme për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në lëndë. Kjo është bërë me dije nga emailat anonim të drejtuar shumicës së avokatëve mbrojtës. Përbërja e kundërligjshme e trupit gjykues të Gjykatës Themelore në mënyrë të drejtpërdrejtë ka ndikuar në rezultatin e kësaj lënde.
70. Sipas nenit 361 të KPP-së, Gjykata Themelore ka qenë e detyruar që ta bazojë aktgjykimin e saj vetëm mbi faktet dhe provat e shqyrtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në shkelje të kësaj dispozite, Gjykata Themelore ka shpallur Dëshmitarin B si dëshmitar armiqësor dhe rrjedhimisht dëshminë e tij të dhënë para gjykatës e ka trajtuar si jo të besueshme. Në vend të kësaj, Gjykata Themelore vendimin e saj e ka bazuar vetëm në dëshmitë e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit K. Dëshmitari K është konsideruar si provë rrethanore nga Gjykata Themelore dhe palët. Kjo ka shkelur praktikën gjyqësore të Kosovës dhe GjPNJ-së sipas të cilave aktgjykimi mund të bazohet vetëm në prova të drejtpërdrejta (dhe jo në ato rrethanore).
71. Dëshmitari A ka qenë dëshmitari i vetëm i cili e ka inkriminuar Z.D.. Dëshmia e tij nuk ka qenë e mjaftueshme për ta vërtetuar fajësinë. Ai është marrë në pyetje disa herë ndërmjet viteve 2008 dhe 2011, kur këto dokumente i janë transferuar prokurorit të PSRK-së. Mbrojtja ka kërkuar nga Gjykata Themelore që të urdhërojë që këto dokumente t'i dorëzohen mbrojtjes, por kjo nuk është bërë kurrë. Rrjedhimisht, nuk mund të përjashtohet që Dëshmitari A është udhëzuar dhe testuar përpara se të jepte deklaratën e tij para prokurorit të PSRK-së. Përveç kësaj, dëshmia e Dëshmitarit A është në vetvete

kontradiktore dhe e paqëndrueshme në disa pika dhe në veçanti në lidhje me rolin dhe veprimet e Z.D..<sup>1</sup>. Në disa pjesë, dëshmia e tij është shumë joreale, për shembull në lidhje me përdorimin e shkopinjve të bejsbollit, meqenëse nuk ka shumë gjasa që këto të mos lënë shenja serioze në trupin e tij. Dëshmia e tij ishte gjithashtu kundërthënëse me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, siç janë dëshmitë e Dëshmitarit B, Dëshmitarit K, Dr. C.B., Dr. G.H. dhe R.S.. Këto dëshmi kanë ngritur dyshime në lidhje me kredibilitetin dhe besueshmërinë e dëshmisë së Dëshmitarit A. Shumë kundërthënie dhe mospërputhje në deklaratat e Dëshmitarit A nuk mund të shpjegohen me kalimin e kohës, por duhet të trajtohen si tregues se ai i fabrikon dëshmitë e tij. Për shkak të këtyre rrethanave, Gjykata Supreme duhet të konstatojë se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë e kanë shpallur të pandehurin fajtor edhe pse nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e tij.

72. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, njëri nga elementet e torturës në kontekstin e një krimi të luftës është se kryerësi synon të shkaktojë dhimbje ose vuajtje. Ky element asnjëherë nuk është provuar apo vërtetuar në këtë rast. Elementet kriminale të krimi të luftës gjithashtu përfshijnë një kërkesë që veprimet të kryhen kundër popullatës civile, ndërsa ky rast ka të bëjë vetëm me dy raste të izoluara. Më tutje, në shkelje të parimeve ligjore të prezumimit të pafajësisë dhe fajësisë individuale, i pandehuri është dënuar edhe pse nuk është vërtetuar se ai ka qenë në dijeni të fakteve që përbëjnë veprën penale. Të paktën ka qenë e nevojshme të vërtetohet se i pandehuri ka qenë në dijeni të fakteve të cilat përbëjnë veprën penale të kryer nga ai.

#### **Avokati mbrojtës A.Q. në emër të I.T.**

73. Propozim: Avokati mbrojtës i I.T. i propozon Gjykatës Supreme që ta lirojë të pandehurin nga akuzat. Ai thekson:

74. Koncepti i dëshmitarit armiqësor: Koncepti i dëshmitarëve armiqësorë nuk parashihet me KPP. Arsyeimi i Gjykatës së Apelit në faqen 21 të aktgjyqimit të saj nuk qëndron. Procedura penale në Kosovë nuk është tërësisht akuzatore, pasi që gjithashtu përmban elemente inkuizitore, siç është mundësia e gjykatës për të mbledhur prova. Për më tepër, "hendeku ligjor" nuk duhet të interpretohet në dëm të të pandehurit siç është bërë në këtë

<sup>1</sup> Lidhur me këtë, referencë i bëhet procesverbalit nga seancat e shqyrtimit gjyqësor të mbajtura më 12 prill 2014, 15 shtator 2014 dhe 16 shtator 2014.

rast. Nuk ka barazi ndërmjet palëve nëse gjykatës i lejohet që të shpik "institute procedurale" në kundërshtim me ligjin. Në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 2 të KPP-së, deklaratat e dëshmitarëve armiqësorë kanë shkelur parimin e "sigurisë juridike" dhe të drejtat e mbrojtjes të mbrojtura me Kushtetutë.

75. Vlerësimi i specialistit mjekësor Dr. M. G.: Raporti i ekspertit të mjekësisë ligjore Dr. M.G. është lexuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Dr. M.G. është dashur të ftohet dhe të dëgjohet gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë që mbrojtjes t'i jepet mundësia që ta sfidojë kredibilitetin e tij profesional dhe shkencor. Kushtet për leximin e deklaratave paraprahe të përcaktuara me nenin 338 (1) të KPP-së nuk janë përmbushur. Më tutje, në shkelje të nenit 341 (3) të KPP-së, palët nuk kanë pasur mundësi që ta marrin në pyetje të tërthortë ekspertin lidhur me raportin e tij. Këto argumente janë ngritur në ankesë, mirëpo nuk janë adresuar nga Gjykata e Apelit.
76. Identifikimi i të pandehurit: Në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, nenit 120 të KPP-së dhe jurisprudencës së gjykatave ndërkombëtare, Gjykata Themelore e ka konsideruar identifikimin e I.T. të bërë nga Dëshmitari A në gjykatore si provë vërtetuese. Deklarata e Dëshmitarit A ka qenë prova e vetme e cila ka mundur të vërtetojë se I.T. ka qenë njëri nga kryerësit. Identifikimi i I.T. nga ai nuk është i besueshëm, duke pasur parasysh se ai fillimisht e ka identifikuar një person tjetër gjatë hetimit dhe duke marrë parasysh deklaratën e tij se e ka parë I.T. pas luftës nga një distancë prej rreth 100 metrash. Për më tepër, ai i ka parë kryerësit, të cilët ai i ka përshkruar se kishin fytyrat e ngjyrosura, vetëm gjatë natës në dritën e qirinjve. Duke e pranuar identifikimin e të pandehurit në gjykatore si provë vërtetuese, është shkelur e drejta e të pandehurit për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, kjo ka shkelur nenin 120 të KPP-së, i cili përcakton se identifikimi përmes fotografive mund të bëhet vetëm gjatë fazës së hetimit. Duke mos marrë parasysh këto aspekte, gjykatat nuk kanë ofruar bazë ligjore për krijimin e identitetit subjektiv të I.T.. Deklarimi në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit se Dëshmitari A i kishte njohur të gjithë kryerësit personalisht dhe për këtë arsye ishte në gjendje që t'i identifikonte ata, është i pasaktë, duke marrë parasysh se Dëshmitari A ka deklaruar se nuk e kishte njohur I.T. para se të ishte ndaluar dhe se ai e kishte njohur atë vetëm më pas.



77. Diagnoza psikiatrike e Dëshmitarit A: Në shkelje të ligjit, gjykatat kanë marrë rolin e ekspertëve të psikiatrisë kur kanë vlerësuar se si diagnoza psikiatrike e Dëshmitarit A ka ndikuar në aftësinë e tij që të japë deklaratë të saktë. Sipas nenit 7 të KPP-së, gjykata ka për detyrë që t'i vërtetojë faktet saktësisht dhe tërësisht. Gjykatat nuk janë ekspertë të psikiatrisë. Prandaj, gjykatat duhet të mbështeteshin tek eksperti gjatë vlerësimit se deri në çfarë mase ka ndikuar diagnoza e Dëshmitarit A në aftësinë e tij për të kuptuar dhe kujtuar faktet.
78. Lidhja në mes të Dëshmitarit B dhe konfliktit: Për ta vërtetuar veprën penale të krimeve të luftës, duhet të vërtetohet lidhja në mes të veprës penale dhe konfliktit të armatosur. Në lidhje me Dëshmitarin A, në aktgjykim thuhet se keqtrajtimit të cilit i ishte nënshtruar ai ka qenë i motivuar nga bashkëpunimi i tij i pretenduar me regjimin serb. Në shkelje të ligjit material penal, lidhja midis mbajtjes së pretenduar të Dëshmitarit B dhe konfliktit të armatosur nuk është provuar apo vërtetuar nga gjykatat. Nuk ka asnjë provë e cila e lidh Dëshmitarin B dhe mbajtjen e tij të pretenduar me konfliktin.
79. Shqiptimi i dënimit: Dënimi i shqiptuar duhet të jetë i drejtë dhe në proporcion me veprën penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. Shqiptimi i burgimit është dënimi më i ashpër i paraparë nga KPP-ja. Gjykatat kanë shkelur ligjin penal në dëm të të pandehurit duke mos e marrë parasysh kalimin e kohës ndërmjet veprave penale të pretenduara dhe procedurës penale e cila mbulon një periudhë prej më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) vitesh.

**Avokati mbrojtës R.M. në emër të S.D.**

80. Propozim: Avokati mbrojtës i S.D. i propozon Gjykatës Supreme që ta hedhë poshtë aktakuzën në mungesë të provave, ose si alternativë t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthejë për rigjykim në Gjykatën Themelore. Ai thekson:
81. Në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 (1.8) i KPP-së, dënimi është bazuar në prova të papranueshme, përkatësisht në dëshminë e Dëshmitarit A. Dëshmitari A ka qenë anonim dhe kundërthënës me vetveten si dhe me provat tjera.
82. Në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 (1.12) i KPP-së, aktgjykimet nuk janë përpiluar në përputhje me nenin 370 të KPP-së. Dispozitivi i

aktgjykimit të Gjykatës Themelore është kundërthënës me vetveten. Arsyetimi është i pamjaftueshëm dhe i mungojnë arsyet për faktet vendimtare. Asnjëri nga aktgjykimet nuk i adreson pretendimet ose provat e paraqitura nga mbrojtja.

83. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në mënyrë të gabuar thotë se avokati mbrojtës *pretendonte* se i pandehuri nuk ka qenë pjesëtar i UÇK-së, ndërkohë që kjo në fakt është vërtetuar nga provat e paraqitura nga mbrojtja, përkatësisht certifikata nr. 1/377 dhe kopja e listës së brigadës, pasi që këto dokumente vërtetojnë se S.D. nuk ka qenë asnjëherë pjesëtar i UÇK-së. Më tutje, S.D. ka konfirmuar para gjykatës se kurrë nuk e ka përdorur pensionin e veteranit të luftës dhe asnjëherë nuk i është dhënë asnjë certifikatë se ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Këto rrethana e përjashtojnë përgjegjësinë penale dhe dështimi për t'i marrë parasysh provat e përmendura ka shkelur ligjin penal sipas nenit 385 (1.2) të KPP-së.

#### **Avokati mbrojtës K.O. në emër të D.D.**

84. Avokati mbrojtës i D.D. i propozon Gjykatës Supreme që t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthejë për rigjykim në Gjykatën Themelore, ose ta lirojë të pandehurin nga akuzat. Ai thekson:

85. Në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 (1.12) i KPP-së, aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë përpiluar në përputhje me nenin 370 të KPP-së. Në të dy aktgjykimet, dispozitivi është në kundërtënie me arsyetimin. Arsyetimit i mungon baza për faktet vendimtare dhe përfundimet janë bazuar vetëm në pjesë të caktuara të provave.

86. Në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 (1.8), aktgjykimet janë bazuar në prova të papranueshme, përkatësisht në dëshmitë e Dëshmitarit A dhe Dëshmitarit K. Këto dëshmi janë thelbësisht të pambështetshme në përputhje me definicionin e përcaktuar me nenin 19 (1.29) të KPP-së dhe për këtë arsye janë të papranueshme në përputhje me nenin 259 (2) të KPP-së. Dëshmitë janë thelbësisht të pambështetshme sepse gjykatat nuk kanë marrë parasysh se këto dëshmi janë kundërthënëse me vetveten, me njëra tjetrën dhe me provat tjera, siç është përkthyer në paragrafët në vijim.

87. Dëshmia e dëshmitarit A nuk është e besueshme ose kredibile. Së pari, ky përfundim mbështetet nga gjuha, shprehjet e fytirës dhe sjellja e përgjithshme e Dëshmitarit A gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pretendimet e Dëshmitarit A përmbajnë shumë kundërthënie, mospërputhje dhe informacione të rreme dhe nuk mbështeten me prova të tjera. Përkundrazi, provat dhe rrethanat tjera kanë ngritur dyshime serioze në lidhje me besueshmërinë dhe kredibilitetin e Dëshmitarit A. Provat/rrethanat në vijim tregojnë se deklaratat e Dëshmitarit A në lidhje me të pandehurin nuk janë të besueshme dhe kredibile: dëshmitë e Dëshmitarit B dhe të dëshmitarëve të tjerë; aplikimi i Dëshmitarit A për statusin e veteranit; raporti i ekspertëve Dr. G.H.; regjistri i pjesëtarëve të UÇK-së; certifikata e organizatave të veteranëve të luftës; lista e veteranëve të luftës të Brigadës 121 dhe certifikata e datës 4 mars 2015; fakti që shtabi i UÇK-së nuk ka qenë i vendosur në një lokacion, por ndodhej në objekte të improvizuara; fakti që D.D. ka qenë pjesë e një brigade tjetër dhe se vëllezërit D. ishin vendosur në brigada të ndryshme; fakti që nuk kishte qendra të ndalimit në shtabin e UÇK-së; fakti që Dëshmitari A para luftës ka pasur një konflikt lidhur me çështjet pronësore dhe juridike me familjen e gjerë të D.D..

88. Dëshmia e Dëshmitarit A gjithashtu nuk është e besueshme, sepse pjesë të saj janë të palogjikshme. Kjo vlen për deklaratën e Dëshmitarit A se ai nuk ka kërkuar ndihmë mjekësore si rezultat i veprave penale të pretenduara të kryera kundër tij. Përkitazi me këtë, shpjegimi i tij se ai nuk ka kërkuar ndihmë mjekësore sepse organizatat vullnetare si Kryqi i Kuq dhe Mjekët e Nënës Terezë ishin të lidhur me ushtarët e UÇK-së, nuk është e besueshme. Një shpjegim më i mundshëm është se Dëshmitari A nuk posedon dokumente mjekësore, sepse ai nuk është lënduar ose keqtrajtuar. Një shembull tjetër është deklarata që Dëshmitari A ka "punuar me" EULEX-in nga viti 2008 dhe se ka pasur regjistrime gjatë gjithë këtyre procedurave, ndërsa prokurori dhe gjykata e kanë mohuar ekzistencën e çfarëdo regjistrimi të veprimeve hetimore të ndërmarra para se procedura penale të fillonte zyrtarisht. Nëse kjo deklaratë e Dëshmitarit A nuk është e vërtetë, kjo tregon qartë se ai nuk është i besueshëm ose kredibil. Nëse është e vërtetë, hetimi është kryer në shkelje të rëndë të procedurës penale duke ndërmarrë veprime hetimore para fillimit zyrtar të procedurës, duke mos respektuar afatet kohore për përfundimin e hetimit dhe duke privuar mbrojtjen nga e drejta për qasje në të gjitha provat.

89. Aktakuza dhe dënimi i të pandehurit janë bazuar në dëshminë e Dëshmitarit A. Kjo dëshmi nuk është e mjaftueshme për ta përmbushur standardin e lartë të të provuarit

përtej dyshimit të arsyeshëm. Dëshmia e Dëshmitarit A nuk është vërtetuar me asnjë provë të drejtpërdrejtë apo rrethanore. Siç është përshkruar në paragrafin 75 më lart, përkundrazi është përgënjeshtuar nga dëshmitarët e tjerë dhe dokumentet. Duke mos i marrë parasysh provat dhe rrethanat që kanë qenë në dobi të të pandehurit, gjykatat kanë shkelur prezumimin e pafajësisë të përcaktuar në nenin 3 të KPP-së. Gjykatat në këtë mënyrë kanë shkelur edhe nenin 7 të KPP-së pasi që provat dhe faktet nuk janë vlerësuar dhe analizuar siç duhet në aktgjykimet e kundërshtuara dhe për shkak se dënimi është bazuar në vërtetim të gabuar faktik.

90. Në shkelje të ligjit material penal, i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të kryer në bashkëkryerje edhe pse elementet e zbatueshme kriminale objektive dhe subjektive nuk janë provuar apo vërtetuar në lidhje me të pandehurin.

#### **Përgjigjet e Kryeprokurorit të Shtetit**

91. Kryeprokurori i Shtetit thekson se të gjitha kërkesat duhet të refuzohen si të pabazuara. Si vërejtje e përgjithshme, ai thekson se shumica e pretendimeve duhet të refuzohen si të pabazuara, sepse ato kanë të bëjnë me vërtetimin faktik të gjykatës, në veçanti argumentet që kanë të bëjnë me besueshmërinë e Dëshmitarit A, që nuk lejohet si arsye për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë siç është përcaktuar me KPP. Lidhur me secilin pretendim, ai thekson:

92. Disa kërkesa kundërshtojnë përmbajtjen e dispozitivit pa vërtetuar asnjë gabim. Dispozitivi është plotësisht në harmoni me pjesën e mbetur të aktgjykimit dhe i përmban të gjitha elementet siç kërkohen me ligj. Për më tepër, është vërejtur se fakti se disa nga detajet e krimeve nuk kanë mundur të vërtetohen, për shembull data e saktë kur është kryer, nuk e zvogëlon faktin se të gjitha elementet e nevojshme të veprës penale janë vërtetuar bindshëm. Dispozitivi gjithmonë duhet të lexohet së bashku me pjesën tjetër të aktgjykimit.

93. Pretendimet se gjykatat kanë shkelur nenin 262 të KPP-së gjatë vlerësimit të dëshmisë së Dëshmitarit A, janë të pabazuara. Asnjëri nga kufizimet e përcaktuara me nenin 262 të KPP-së nuk janë të zbatueshme pasi që mbrojtja ka pasur mundësi që të marrë Dëshmitarin A në pyetje të tërthortë dhe e ka bërë këtë fuqishëm, identiteti i Dëshmitarit

A ka qenë i njohur për mbrojtjen dhe Dëshmitari A nuk është shpallur dëshmitar i mbrojtur.

94. Pretendimet se gjykatat kanë shkelur KPP-në kur e kanë lejuar konceptin e dëshmitarëve armiqësorë, janë të pabazuara. Mundësia e konfrontimit të një dëshmitari me deklaratat e tij/saj të mëparshme në rast se zbulohet se ka devijuar nga këto deklarata është i nevojshëm për zhvillimin e një procesi të drejtë. Institucioni i dëshmitarëve armiqësorë nuk parashikohet shprehimisht në KPP. Mungesa e një mundësie për të sfiduar kredibilitetin e një dëshmitari duhet të konsiderohet si një gabim i legjislativit në KPP. Mungesa e një mundësie të tillë krijon rrezik për integritetin e procedurës, krijon zbrazëti që promovon frikësimin e dëshmitarëve dhe qëndron në kundërshtim me parimet e përgjithshme që rregullojnë procedurën penale sipas KPP-së, të tilla si ato të përcaktuara në nenet 7, 299 (3) dhe 329 (1) dhe (4) të KPP-së. Për më tepër, neni 257 (2) i KPP-së përcakton që provat duhet të shpallen si të papranueshme kur kodi ose dispozita të tjera ligjore shprehimisht e përcaktojnë këtë. Lidhur me marrjen në pyetje ose ekzaminimin e dëshmitarit, kufizimet janë përcaktuar në nenin 257 (4) të KPP-së. Asnjëra nga këto rrethana nuk ekzistojnë në rastin aktual. Prandaj, në rast të armiqësisë, provat e marra përmes marrjes së tërthortë në pyetje të një dëshmitari nga ana e palës që e ka ftuar atë dëshmitar bie nën kompetencën e përgjithshme diskrecionale të secilës gjykatë për ta pranuar dhe vlerësuar. Zbatimi i konceptit të dëshmitarëve armiqësor nuk e ka shkelur parimin e barazisë së armëve pasi që janë vendosur rregulla të njëjta për të dy palët në procedurë. Për më tepër, nuk ka shkelur parimin *In Dubio Pro Reo* të përcaktuar në nenin 3 të KPP-së. Në këtë drejtim, është vërejtur se ky parim zbatohet vetëm për të drejtën materiale penale dhe jo për dispozitat e procedurës penale.

95. Pretendimet lidhur me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore janë të pabazuara. Trupi gjykues i Gjykatës Themelore përbëhet nga tre gjyqtarë të EULEX-it në pajtim me praktikën e cila është përdorur në shumë raste të gjykuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës. Kjo praktikë është e vetmja mënyrë për të siguruar gjykimin e veprave penale të kryera brenda juridiksionit të kësaj gjykate. Avokati mbrojtës nuk e ka kundërshtuar përbërjen e trupit gjykues në fillim të shqyrtimit gjyqësor. Avokati mbrojtës nuk e ka ngritur asnjë kundërshtim gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër caktimit të gjyqtarës së EULEX-it A.A.-G. në trupin gjykues, që do të thotë se asnjëri nga të pandehurit nuk ka pasur ndonjë arsye për të dyshuar në paanshmërinë e saj. Edhe në qoftë se ka pasur disa

shkelje të vogla brenda rregullave të brendshme të EULEX-it në lidhje me caktimin e gjyqtarëve në lëndë penale, nuk ka ekzistuar ndonjë paragjykim real. Të pandehurit kanë pasur të drejtë për një gjykim të drejtë nga gjyqtarë të paanshëm.

96. Në kundërshtim me atë që pretendon avokati mbrojtës i A.D. dhe B.D., vepra penale e krimeve të luftës mund të kryhet kundër vet popullit të tij. Pyetja se kush mund të jetë viktimë e një krimi lufte është e lidhur ngushtë me nocionin e një lidhje ndërmjet veprës dhe konfliktit të armatosur. Në këtë rast, nuk ka dyshim se veprat e kryera kundër Dëshmitarit A – i cili dyshohej për bashkëpunim me regjimin serb - ishin mjaft të lidhura me konfliktin e armatosur të pranishëm në atë kohë në Kosovë. E njëjta gjë vlen edhe për Dëshmitarin B, i cili ishte në shënjestër për arsye të ngjashme.
97. Pretendimet e ngritura nga avokati mbrojtës i D.D. lidhur me analizën e provave nga gjykata, janë të pabazuara. Gjykata Themelore ka sqaruar në hollësi vlerësimin e saj të provave. Ajo ka paraqitur në detaje se përse ka zgjedhur që të mbështetej në dëshminë e Dëshmitarit A, përkundër mangësive të caktuara në emër të tij dhe ka sqaruar pse ka gjetur disa prova që kundërshtojnë deklarinimin e tij si jo të besueshme. Vërtetimet faktike të paraqitura në aktgjykimin e Gjykatës Themelore nuk lënë hapësirë për dyshime.
98. Pretendimi i ngritur nga avokati mbrojtës i S.D. lidhur me mungesën e arsytimit në lidhje me certifikatën e cila gjoja tregon se ai nuk ka qenë pjesëtar i UÇK-së, është i pabazuar. Argumentet janë të lidhura ngushtë me fushën e vërtetimit të gjendjes faktike dhe si të tilla nuk duhet të lejohen në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Fakti se një diskutim i tillë nuk është përfshirë në aktgjykime nuk do të thotë që kjo provë është shpërfillur.
99. Pretendimi i ngritur nga avokati mbrojtës i F.D. lidhur me kundërthëniet në aktgjykimin e Gjykatës Themelore lidhur me rolin e F.D. në rrahjen e dëshmitarit A nuk është vetëm i pabazuar, por duhet të refuzohet në këtë fazë të procedurës.
100. Pretendimi i ngritur nga avokati mbrojtës i N.D. se si Gjykata Themelore ashtu edhe Gjykata e Apelit kanë dështuar të argumentojnë se me cilat prova janë paraparë elementet e bashkëkryerjes, është e pabazuar. Përkundrazi, trupi gjykues në mënyrë bindëse ka sqaruar se pse ka gjetur që krimi i akuzuar ishte kryer në bashkëkryerje.

101. Pretendimi i avokatit mbrojtës të Z.D. se nuk është e qartë se cili kod është zbatuar gjatë përcaktimit të përgjegjesisë penale, është i pabazuar, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar sqaron në hollësi se cili ligj ishte i zbatueshëm dhe pse. Pretendimet se trupi gjykues nuk ka arritur të përcaktojë elementet e ekzistencës së veprës penale, një datë të caktuar kur janë kryer veprimet kriminale dhe veprimet konkrete të secilit të pandehur janë të gjitha pa meritë. Prokuroria nuk pajtohet me pretendimin e avokatit mbrojtës se Gjykata Themelore ka tejkualuar aktakuzën në lidhje me identitetin e saj objektiv. Për më tepër, prokuroria nuk pajtohet me avokatin mbrojtës se aktgjykimet e formës së prerë të gjykatave kombëtare ose GjPNJ-së lidhur me veprat penale të krimeve të luftës mund të bazohen vetëm në prova të drejtpërdrejta dhe jo në prova rrethore. Nuk ekziston një rregull i tillë në KPK dhe jurisprudenca ndërkombëtare e gjykatave ndërkombëtare nënvizon se trupi gjykues mund të mbështetet në prova të drejtpërdrejta ose rrethore për të mbështetur gjetjet e tij. Argumentimi i mbrojtjes se veprat e pretenduara në aktakuzë ishin incidente të izoluara dhe jo të drejtuara kundër popullatës civile, është i pabazuar.

102. Pretendimi i ngritur nga avokati mbrojtës i I.T. se mbrojtjes nuk i është dhënë mundësia që ta marrë në pyetje të tërthortë M.G., është i pabazuar. Sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor më 13 janar 2015, avokati mbrojtës i I.T. ka qenë i pranishëm në seancë dhe nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim duke e konsideruar raportin si të lexuar. Lidhur me identifikimin e I.T., prokuroria pohon se besueshmëria e dëshmitarit A nuk mund të kontestohet më në këtë fazë të procedurës. Në kundërshtim të asaj që pretendohet nga avokati mbrojtës i I.T., keqtrajtimi i dëshmitarit B ka ndodhur për shkak të kundërshtimit të tij të pretenduar ndaj UÇK-së. Gjykata nuk e ka shkelur ligjin penal edhe pse kalimi i kohës nga kryerja e mundshme e veprës deri në shqiptimin e dënimit nuk është konsideruar si rrethanë lehtësuese. Brenda kufijve të nenit 74 të KPRK-së, trupi gjykues ka diskrecion të përcaktojë se cilat rrethana lehtësuese janë të zbatueshme. Kalimi i kohës nuk është rrethanë lehtësuese sipas nenit të lartpërmendur dhe prandaj asnjë ligj nuk është shkelur.

103. Gjykatat tashmë i kanë trajtuar argumentet e ngritura nga avokati mbrojtës i J.D. në kërkesat e mëparshme. Për më tepër, pretendimi lidhur me vlerësimin e provave nga trupi gjykues, në veçanti besueshmëria e Dëshmitarit A, nuk duhet të trajtohet përsëri nga Gjykata Supreme në rastin e mbrojtjes së ligjshmërisë.

104. Lidhur me kërkesën e përbashkët të F.D. dhe N.D., prokuroria pohon se neni 432 i KPP-së është i qartë lidhur me arsyet e lejuara për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Pasi që gjendja faktike është vërtetuar nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, kërkesa duhet të refuzohet në lidhje me pretendimet që kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.
105. Pretendimet e ngritura nga avokati mbrojtës i S.S. lidhur me përbërjen e trupit gjykues, janë të pabazuara. Së pari, pretendimi se kryetari i trupit gjykues e ka zgjedhur në mënyrë të veçantë gjyqtaren A.A.-G. në trupin gjykues në kundërshtim me procedurat, politikat dhe rregullat për përzgjedhjen e kolegjeve, është i pabazuar. Për më tepër, mbrojtja nuk është në gjendje të sqarojë se cilat dispozita dhe korniza ligjore janë shkelur gjatë procesit. Së dyti, pretendimet se sipas një liste të gjyqtarëve, dy gjyqtarë të mundshëm janë anashkaluar, në mënyrë që kryetari i trupit gjykues ta caktojë gjyqtaren A.A.- G., janë të pabazuara. Gjykata e Apelit tashmë ka sqaruar në aktgjykimin e saj se nuk ka pasur listë për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në vitin 2013. Së treti, nuk ka asnjë element për të kundërshtuar paanësinë e trupit gjykues dhe për këtë arsye të pandehurit kanë pasur të drejtë në një gjykim të drejtë.
106. Kërkesa e mbrojtjes për të mbajtur seancë për të hetuar nëse trupi gjykues është përbërë në mënyrë të parregullt, duhet të refuzohet pasi që KPP-ja nuk e parasheh mbajtjen e seancës për këto qëllime në kuadër të procedurës së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.
107. Sa i përket emailave të paautorizuar të cilët mbrojtja i ka pranuar gjatë tetorit dhe nëntorit 2016, dërguesit nuk janë ose nuk kanë qenë staf i EULEX-it. Përveç kësaj, nuk ka asnjë provë se emailat janë autentik, të saktë dhe të besueshëm. Emailat e datës tetor dhe nëntor 2016 kanë të bëjnë me thashetheme ose biseda të pretenduara midis anëtarëve të stafit të EULEX-it dhe gjyqësorit të EULEX-it. Madje as adresat e postës elektronike nuk i përkasin EULEX-it.
108. Emailat të cilat mbrojtja ia ka bashkëngjitur kërkesës së saj është kopje e shkëmbimit të postës elektronike e cila gjoja ka ndodhur ndërmjet kryetarit të trupit gjykues të rastit Drenica II, personit kontaktues të gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it, por shkëmbimi i emailave tregon



shqetësimet që kanë të bëjnë thjesht me mundësinë që një numër i gjyqtarëve të jenë pjesë e trupit gjykues për shkak të përjashtimit, kohës së shkurtër të kontratave dhe kohëzgjatjes së përvojës. Kryetari i trupit gjykues nuk ka bërë asnjë sugjerim për emrin e kandidatit për anëtar të trupit gjykues.

109. Në përputhje me nenet 432-441 të KPP-së, prova të reja nuk paraqiten me rastin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe prandaj provat e mbrojtjes, të paraqitura si prova materiale B, nuk mund të jetë e pranueshme.

110. Prokuroria pohon se mungesa e procesverbalit të fjalëpërfjalshëm nuk përbën arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas neneve 432 (1.2) dhe 384 (1) të KPP. Për më tepër, mbrojtja do të duhej të demonstronte shkeljen e pretenduar e cila ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor për të pasur arsye për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 432 (1.3) të KPP-së. Mbrojtja nuk ka përshkruar asnjë deklaratë specifike të dëshmitarit që mund të përmbajë dëshmi shfajësuese dhe për këtë arsye të ndikojë në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

111. Sa i përket pasaktësive të pretenduara të deklaratave në procedurë paraprake, Prokuroria vëren se Neni 131 (4) i KPP-së e lejon mundësinë e përmbledhjes së deklaratave në procedurë paraprake. Po ashtu, vlera e deklaratave në procedurë paraprake është e kufizuar sipas Nenit 123 të KPP-së. Pasaktësia e pretenduar e deklaratave në procedurë paraprake është e pabazuar.

112. Argumentimi në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (paragrafët 113-284) ka të bëjë me standardin e provës dhe vlerësimin e provave të bërë nga trupi gjykues dhe Gjykata e Apelit. Neni 432 i KPP-së ka përcaktuar baza të lejueshme për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Pasi që situata faktike veç është përcaktuar nga Kolegji i Gjykatës Themelore dhe nga Kolegji i Gjykatës së Apelit, atëherë kërkesa lidhur me pretendimet për përcaktimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes duhet të hidhet poshtë.

113. Kërkesa e mbrojtjes për sigurimin e provave të reja, e datës 10 Maj 2017 nuk ka ndonjë meritë. KPP-ja nuk parashih për Gjykatën Supreme mbajtjen e seancave provuese apo ndërmarrjen e ndonjë veprimi hetimor në rastet e mbrojtjes së ligjshmërisë. Neni 407 (2) i KPP-së, i cili u referohet neneve 389 dhe 406 të KPP-së për tu zbatuar *mutatis mutandis* i

referohet vetëm ndonjë rasti të apelimit në Gjykatën Supreme. Referenca e bërë nuk zbatohet për mbrojtjen e ligjshmërisë. Nuk ka asnjë dispozitë në nenet 432-441 të KPP-së që e rregullon procedurën në rastet e mbrojtjes së ligjshmërisë.

---

## **TË GJETURAT – PYETJET PROCEDURALE**

### **Përbërja e trupit gjykues (kolegjit)**

114. Kolegji vërteton se ky rast është definuar si “I hapur” në pajtueshmëri me definicionin e paraparë në Nenin 1 A të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë nr. 03/L-053 të ndryshuar me ligjet nr. 04/L-273 dhe 05/L-103 (këtu e tutje: Ligji mbi kompetencat). Me vendimin e datës 27 Prill 2017, KGJK-ja ka vendosur se Kolegji do të përbëhet nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor dhe se kryetar i trupit gjykues do të jetë gjyqtari i EULEX-it. Prandaj, Kolegji ka qenë në përbërje të saktë.

### **Ligjet e zbatueshme**

115. Kolegji vërteton se ecuria e procedurës në këtë rast është udhëhequr nga KPP-ja pasi që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë ushtruar pas hyrjes në fuqi të KPP-së (Neni 539 i KPP-së). Ashtu siç edhe është vendosur dhe arsyetuar me të drejtë nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, KPP-ja ka qenë edhe ligj i zbatueshëm procedural në procedurën penale të atakuar dhe KPPK-ja është edhe ligj i pavarur për sa u përket akuzave.

### **Pranueshmëria**

116. Kolegji gjen se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të ushtruara ndaj këtij rasti janë të pranueshme pasi që janë ushtruar nga persona të autorizuar, kundër aktgjykimeve të formës së prerë dhe në afatet e caktuara kohore (Neni 433 i KPP-së).

### **Kërkesat procedurale**

117. Në këtë shqyrtim, Kolegji do i adresoj propozimet për mbajtjen të seancës me qëllim të hetimit nëse Kolegji i Gjykatës Themelore nuk e kishte përbërjen e duhur, për ta thirrur

punëtorin e EULEX-it, që të dëgjohej si dëshmitar gjatë seancës në fjalë, pranueshmërinë e dokumenteve të bashkëlidhura në kërkesën e S.S. dhe që kërkesa të ofrohet me një kopje të raportit të pretenduar të paraqitur nga punëtori i EULEX-it. Për arsyet e cekura në paragrafët pasues, Kolegji ka gjetur se asnjëri prej këtyre propozimeve nuk mund të miratohet dhe se nuk ka nevojë për ndonjë procedurë tjetër.

118. Kolegji fillimisht vëren se ecuria e procedurës në rastet lidhur me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë përcaktohet nga nenet 418 dhe 432 – 441 të KPP-së. Sa i përket ecurisë së procedurës, neni 435 (1) dhe (2) i KPP-së përshkruan se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nëse nuk është e papranueshme ose e paraqitur jashtë afatit, duhet të dërgohet palës kundërshtare e cila mund të paraqes përgjigje ndaj saj, dhe kjo duhet të konsiderohet në shqyrtimin e Kolegjit. Neni 418 (4) i KPP-së, i cili zbatohet për të gjitha mjetet e jashtëzakonshme juridike, i referohet një numër nenesh të cilat gjithashtu duhet të zbatohen për kërkesat e mbrojtjes së ligjshmërisë. Këto dispozita përfshijnë parimin e përgjithshëm të paanshmërisë, dispozitat që i rregullojnë format e kërkesave dhe përgjigjeve e gjithashtu edhe dispozitat e përgjithshme të afateve kohore.

119. Kolegji vëren se asnjë prej dispozitave të sipër përmendura apo nenet të cilave iu referohen ato, nuk përfshin ndonjë mundësi procedurale sipas së cilës Gjykata Supreme mund të mbaj një shqyrtim të hapur me palët e pranishme apo të mbaj ndonjë seancë dëgjimore me qëllim të mbledhjes së provave të reja. Në këtë aspekt, duhet të theksohet se procedurat e jashtëzakonshme janë krejtësisht të ndryshme nga procedurat e zakonshme apeluese të shkallës së dytë apo të tretë, gjegjësisht rastet kur Gjykata e Apelit apo Gjykata Supreme gjykon një mjet të zakonshëm juridik të ndonjë ankese kundër aktgjykimeve. Procedura ankimore pranë Gjykatës së Apelit rregullohet me nenet 380 – 407 përderisa nenet 389 – 407 zbatohen *mutati smutandis* në procedurën apeluese pranë Gjykatës Supreme në raste specifike dhe kur Neni 374 (2) e lejon një ankesë të tillë. Nenet 383 (2) dhe (3) të KPP-së definojnë qartë se nën çfarë rrethanash apeluesi mund të paraqes prova të reja, fakte apo baza në ankesë. Neni 391 i KPP-së përshkruan se vendimi i Gjykatës së Apelit apo i Gjykatës Supreme për këto raste duhet të merret në shqyrtim të mbajtur nga Kolegji ose në seancë dëgjimore. Në pajtueshmëri me Nenin 392 të KPP-së, shqyrtimi duhet të mbahet vetëm atëherë kur është e domosdoshme marrja e provave të reja apo përsëritja e provave të disponueshme për shkak të përcaktimit të gabueshëm ose jo-të plotë të gjendjes faktike. Nenet 390 dhe 393 përshkruajnë më tutje se cilët persona

duhet të njoftohen apo të ftohen në shqyrtim apo në Seancë të Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme e gjithashtu edhe dispozitat përkatëse. Asnjë prej dispozitave të referuara nuk zbatohen në procedurën e zbatueshme për rastet e kërkesave të mbrojtjes së ligjshmërisë, përfshirë edhe mundësinë për seanca provuese. Kjo e fundit sistematikisht buron nga ndalimi që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të ngrihen mbi bazat e përcaktimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike (Neni 432 (2) i KPP-së). Ligjbërësi logjikisht ka vendosur se asnjë seancë provuese nuk duhet të lejohet atëherë kur vet kërkesa nuk mund të bazohet mbi pretendime të pasaktësive faktike.

120. Bazuar në sa u tha më sipër, Gjykata Supreme nuk mund të gjej baza as për ta mbajtur seancën e as për të marr prova të reja në formë të dokumenteve të bashkëlidhura. Kalimthi (*si obiterdictum*), Kolegji vëren se dokumentet e bashkëlidhura duhet të konsiderohen si thelbësisht të pa-mbështetshme sipas përkufizimit të dhënë në Nenin 19 (1.29) të KPP-së. Ky nen përshkruan se prova ose informata është thelbësisht e pa-mbështetshme nëse origjina e provës është e panjohur, bazohet në thashetheme apo në dukje të parë është e pamundshme ose e pabesueshme. Të gjitha *email*et e bashkëlidhura në kërkesat e S.S. janë thelbësisht të pabesueshëm pasi që nuk ka asnjë informatë lidhur me origjinën e tyre.

121. Sa i përket kërkesës që Këshilltarit Mbrojtës të S.S. ti jepet raporti i cili gjoja se është paraqitur nga punëtori i EULEX-it, kolegji fillimisht vëren se Gjykata Supreme – të cilës edhe i është adresuar kjo kërkesë – nuk ka qasje në një raport të tillë por edhe vet këshilltari mbrojtës pranon se raporti gjoja se është paraqitur te autoritetet e EULEX-it e jo në Gjykatën Supreme. Kolegji më tutje vëren se nuk është detyrë e Gjykatës që të mbledh dhe/ose t’u jep palëve dokumente të cilat nuk janë paraqitur në rastin në fjalë. Po ashtu, sikurse veç u sqarua më sipër, në procedurën për Mbrojtje të ligjshmërisë nuk mbledhen prova të reja (shih më sipër paragrafin 119). Kolegji sipërfaqësisht vëren se në rast se raporti i cili referohet se përmbante pretendime për keq-zbatim të rregullores së brendshme të EULEX-it dhe nëse ai i është dorëzuar autoriteteve të EULEX-it, atëherë ky i fundit e ka diskrecionit për të hapur hetime të brendshme lidhur me shkeljet e pretenduara të procedurave të brendshme operuese.

122. Dhe në fund, Kolegji vëren se kërkesat për Mbrojtje të ligjshmërisë në pajtueshmëri me Nenin 435 (2) të KPP-së i janë dërguar Krye-Prokurori i shtetit, i cili si palë kundërshtuese, ka ushtruar përgjigje ndaj kërkesave të dërguara.

123. Asnjë procedurë e mëtutjeshme nuk është e nevojshme.

---

### **TË GJETURAT-- MERITAT E KËRKESAVE**

#### **Vërejtje të përgjithshme në sferën e Gjykimit të Kolegjit**

124. Në këtë seksion Kolegji do bëj disa vërejtje të përgjithshme lidhur me kufizimet specifike të zbatueshme në fushëveprimin e vlerësimeve të Kolegjit ndaj meritave të kërkesës për Mbrojtje të ligjshmërisë, sikurse janë paraparë në KPP. Më tutje Kolegji do të listoj pretendimet të cilat do vlerësohen dhe adresohen nga Kolegji.

125. Fushëveprimi i gjykimit të Kolegjit ndaj një kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë pikë së pari përkufizohet nga Neni 436 (1) i KPP-së. Sipas këtyre dispozitave, Kolegji si rregull kryesore e ka kufizimin e vetes për të adresuar ato shkelje ligjore në të cilat pretendon paraqitësi i kërkesës dhe vetëm në rast se Kolegji vërteton se shkaqet për të cilat ka marrë vendim në dobi të njërit prej të pandehurve ekzistojnë edhe për ndonjërin nga të bashkë-akuzuarit, atëherë vepron sipas detyrës zyrtare sikurse kërkesa e tillë të ishte paraqitur nga ai i bashkë-akuzuar. Si rrjedhojë dhe në kundërshtim me çfarë pretendon këshilltari mbrojtës i N.D., palët nuk mund ti kërkojnë Gjykatës Supreme që në terma të përgjithshëm të vlerësoj tërësisht “të gjitha dosjet e rastit” dhe të ekzaminojë sipas detyrës zyrtare nëse ekzistojnë ose jo shkelje procedurale apo penale. Në të kundërtën, KPP-ja e përshkruan qartë se Kolegji është i obliguar të vlerësoj vetëm pretendimet specifike të ngritura nga palët.

126. Fushëveprimi i gjykimit të meritave të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë më tutje kufizohet edhe me përkufizimet e cekura në Nenin 432 (2) të KPP-së, sipas të cilave nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike. Ky kufizim i ndalon palët që – në mënyrë direkte apo jo-direkte – ta sfidojnë

vërtetimin faktik të gjykatave. Kolegji vëren se ky kufizim i përfshin të gjitha pyetjet lidhur me vlerësimin e provave e gjithashtu edhe besueshmërinë e dëshmitarëve të caktuar dhe vlerën provuese të dëshmive të tyre<sup>2</sup>. Në rast se pala, pavarësisht vërtetimeve faktike të bëra nga Gjykatat e sfidon vendimin, atëherë Gjykata Supreme, bazuar në Nenin 437 të KPP-së, është e obliguar që të refuzoj këto argumente si të pabazuara dhe të mos i vlerësoj më tutje.

127. Kolegji vëren se kërkesat e ushtruara në këtë rast përfshijnë një numër të madh argumentesh që lidhen ngushtë ose drejtpërdrejt me vlerësimin e provave të bëra nga Gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë. Kjo veçanërisht vlen për argumentet që lidhen me vlerësimin e besueshmërisë dhe vlerës provuese të dëshmisë së dhënë nga Dëshmitari A dhe argumentet që ndërlidhen me vlerësimin e bëra nga Gjykata ndaj dëshmitarëve tjerë, dëshmive përfshirë edhe dëshmitarin ekspert apo provave dëshmuese. Në këtë aspekt, Kolegji dëshiron të shpreh, se pala nuk mund ta kundërshtoj vërtetimin faktik të gjykatës duke pretenduar se gjykata ka bërë shkelje të standardeve ligjore të vlerësimit të provave.

128. Po ashtu, pretendimet se nuk ka pasur prova për të vërtetuar ndonjë element specifik të krimit, të tillë si ata që zbatohet për bashkë-kryerjen, në fakt vetëm e kundërshtojnë vërtetimin faktik të dhënë nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit dhe prandaj nuk janë të lejueshme në këtë fazë të procedurës. Kur jemi këtu, Gjykata Supreme thjesht vëren se Trupi Gjykoës ka shpjeguar përse ka gjetur se krimi i ngarkuar është kryer në bashkë-kryerje.

129. Edhe çështja e identifikimit e ngritur në kërkesën e I.T. bie nën kategorinë e vlerësimit faktik dhe prandaj nuk është e lejueshme sipas Nenit 432 (2) të KPP-së. Me qëllim të sqarimit të kësaj çështjeje, Kolegji shkurtimisht vëren se në procesverbalin e shqyrtimit të mbajtur me 17 Nëntor 2014, faqe 12, kolegji ka shpjeguar hollësisht se përse identifikimi i bëra në atë ditë nuk do kishte asnjë ndikim paragjykoës në dëm të pikërisht këtij të pandehuri.

---

<sup>2</sup>Shih për shembull paragrafin 3.2 të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të datës 13 Tetor 2015 në rastin nr. Pml.Kzz 72/2015 dhe paragrafin 42 të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të datës 13 Maj 2016 në rastin nr. Pml.Kzz 18/2016.

130. Në pajtueshmëri me Nenin 432 (1) të KPP-së kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të ushtrohet në rast të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë. Kolegji i ka lexuar tërësisht kërkesat e ushtruara në këtë rast dhe ka përcaktuar pretendimet në vijim, të cilat do të adresohen një nga një në seksionet pasuese:

- *Pjesëmarrja ekskluzive e Gjyqtarëve të EULEX-it në Kolegjin e Gjykatës Themelore*
- *Caktimi i Gjyqtarës së EULEX-it A.A.-G. në Kolegjin e Gjykatës Themelore*
- *Mungesa e regjistrimit tekstual (fjalë për fjalë) të procedurës*
- *Koncepti i dëshmitarit armiqësor*
- *Përdorimi i deklaratave në procedurë paraprake*
- *E drejta për një gjykim të drejtë*
- *Përmbajtja e aktgjykimeve të shkruara*
- *Parimi i ligjshmërisë*
- *Shtrirja e akuzës*
- *Dëshmitari A si provë për përcaktimin e fajësisë (Nenet 262 dhe 361)*

#### **Pjesëmarrja ekskluzive e gjyqtarëve të EULEX-it në Kolegjin e Gjykatës Themelore**

131. Në këtë seksion, Kolegji do të adresoj pretendimet lidhur me pjesëmarrjen ekskluzive të Gjyqtarëve të EULEX-it në Kolegjin e Gjykatës Themelore. Shkurtimisht, Mbrojtja pretendon se përbërja e Kolegjit të Gjykatës Themelore ka qenë në shkelje të Ligjit mbi Kompetencat pasi që ky ligj parasheh se edhe një gjyqtar vendor do duhej të ishte pjesë e kolegjit. Kolegji i hedh poshtë këto pretendime si të pabaza.

132. Në pajtueshmëri me Nenin 41 (2) të KPP-së, kërkesa për përjashtim mund të ushtrohet jo më vonë se para përfundimit të shqyrtimit kryesor për arsyet e parapara në Nenin 39 (3) të KPP-së, përjashtimin e kërkon para fillimit të shqyrtimit kryesor. Fillimisht, kolegji vëren se asnjë nga palët nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim lidhur me përbërjen e kolegjit në fillim të shqyrtimit kryesor, përkundër se edhe atëherë ka qenë e ditur se kolegji përbëhej nga tre gjyqtarë të EULEX-it. Kolegji është i mendimit se kjo do të krijonte mundësinë e keqpërdorimit të së drejtës për ta kundërshtuar përbërjen e kolegjit në rast se çështja do të ishte ngritur në shkallën e dytë apo të tretë, edhe nëse pala nuk ka

pasur ndonjë kundërshtim ndaj tij gjatë shqyrtimit kryesor. Ndonjë interpretim tjetër do shpinte në përfundimin se pyetja e parashtruar në fillim të shqyrtimit kryesor lidhur me përbërjen e kolegjit nuk paskësh ndonjë rëndësi ligjore.

133. Së dyti, Kolegji pajtohet me Gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë se Kolegji i Gjykatës Themelore ka qenë në përbërje të saktë. Sikurse është sqaruar hollësisht nga Gjykata Themelore (paragrafët 12-14), ka qenë një praktikë e vendosur qartë se rastet penale të Gjykatës Themelore të Mitrovicës të gjykoheshin nga kolegje të përbëra krejtësisht nga gjyqtarë të EULEX-it dhe kjo është konfirmuar edhe më vonë në marrëveshjen në mes të Shefit të EULEX-it dhe KGJK-së.

134. Së treti, për rastin në fjalë, doktrina e nevojës, e njohur nga Parimet Bangalore të sjelljes së gjyqësorit, e Shtatorit 2007 është e zbatueshme<sup>3</sup>.

Doktrina e nevojës ia mundëson një gjyqtari, i cili përndryshe është i diskualifikuar, që ta dëgjoj dhe të vendos për një rast, në rast se mos-bërja e kësaj rezulton me padrejtësi. Kjo vjen në shprehje atëherë kur nuk ka ndonjë gjyqtar tjetër në dispozicion, i cili nuk është njësoj i përjashtuar, apo nëse shtyrja ose keq-gjykimi do të shkaktoj vështirësi të patejkalueshme, apo nëse Gjykata nuk mund të mblidhet për të dëgjuar dhe vendosur për çështjen në fjalë në rast se gjyqtari në fjalë nuk e merr rastin.

Duke i pasur parasysh rrethanat në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, ku gjyqtarët lokalë (shqiptarë apo serbë) nuk ishin dhe akoma (tani që po përgatitet ky tekst) nuk janë në gjendje që të marrin rastet dhe kolegjet e përbëra krejtësisht nga gjyqtarët e EULEX-it kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë e vetmja mënyrë për ta mbajtur gjykatën. Prandaj fakti që trupi gjykues i Gjykatës Themelore përbëhej vetëm nga Gjyqtarë të EULEX-it nuk përbën ndonjë shkelje të procedurës penale. Përkundrazi, në kontekstin e situatës së veçantë të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, caktimi i një kolegji me vetëm gjyqtarë të EULEX-it ka qenë e vetmja mundësi për të siguruar të drejtat e të pandehurve të cilido rast (dhe jo vetëm këtij) për të pasur qasje në drejtësi janë respektuar si të drejta të një procesi të rregullt ligjor<sup>4</sup>

<sup>3</sup>Shih paragrafin 100 tëKomentarit të Parimeve Bangalore të sjelljes së gjyqësorit, të nxjerra nga UNODC, në linkun [https://www.unodc.org/documents/corruption/publications/unodc\\_commentary-e.pdf](https://www.unodc.org/documents/corruption/publications/unodc_commentary-e.pdf).

<sup>4</sup>Deklarata universale e të drejtave të njeriut (1949) Neni 10: "Secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të paanshme e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe për mbështetshmërinë e çdo akuze penale kundër tij". Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (1976), Neni 14 (1): "Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë. Çdo person ka tëdrejtëqëçështja e tij të trajtohet me paanësi dhe publikisht nga njëgjykatë"



135. Për këto arsye, pretendimet lidhur me përbërjen e kolegjit krejtësisht nga gjyqtarë të EULEX-it janë të pabazuara.

### **Caktimi i gjyqtarës së EULEX-it A.A.-G. në Kolegjin e Gjykatës Themelore**

136. Në këtë seksion, Kolegji do të adresoj pretendimet lidhur me caktimin e gjyqtarës së EULEX-it A.A.-G. në Kolegjin e Gjykatës Themelore dhe mënyrën si këto pretendime janë adresuar para Gjykatës së Apelit. Shkurtimisht, mbrojtja pretendon se caktimi i gjyqtarës së EULEX-it A.A.-G. në Kolegjin e Gjykatës Themelore ka shkelur rregulloren e brendshme të caktimit të gjyqtarëve të EULEX-it në rastet penale [REDACTED]

[REDACTED] Mbrojtja gjithashtu argumenton se Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në Prishtinë mund të shërbejnë në Mitrovicë vetëm si gjyqtarë zëvendësues.

137. Krejt në fillim Kolegji vëren se kundërshtimet lidhur me caktimin e gjyqtarës së EULEX-it A.A.-G. në Kolegjin e Gjykatës Themelore janë bërë pas shqyrtimit kryesor. Bazuar në afatet kohore të cekura në Nenin 41 (2) të KPP-së, këto pretendime janë të pasafatshme.

138. Po ashtu këto pretendime bazohen në një raportim televiziv të Koha Vision dhe emaile anonime, të cilat gjoja se janë dërguar nga punëtorë të EULEX-it. Sikurse u shpjegua nën titullin “kërkesat procedurale”, Kolegji ka vendosur se në shkallën e tretë të procedurës nuk mund të pranohen prova të reja. Si *obiter dictum*, Kolegji vëren se dokumentet e bashkëlidhura duhet të konsiderohen si thelbësisht të pa-mbështetshme (*emaile të*


---

*kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e ngritur sipas ligjit, që do të vendosë qoftë për përcaktimin e çdo akuze të karakterit penal që drejtohet kundër tij, qoftë për konfliktet lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij në fushën civile. Shtypi dhe publiku mund të largohen gjatë gjithë procesit ose të një pjese të tij, qoftë kur e kërkon interesi i sjelljes së moralshme, i rendit publik ose i sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ose kur e kërkon interesi i jetës private të palëve, qoftë edhe kur gjykata e quan krejtësisht të domosdoshme në qoftë se, për disa rrethana të veçanta të çështjes, publiciteti mund të dëmtonte interesat e drejtësisë; megjithatë çdo gjykim i dhënë në çështjen penale ose civile do të jetë publik, me përjashtim të rasteve kur interesi i të miturve kërkon ndryshe ose në qoftë se procesi ka të bëjë me mosmarrëveshje martesore ose me kujdestarinë e fëmijëve”.* Konventa ndërkombëtare e të drejtave të njeriut (1950), Neni 6 (1): “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

*dërguara nga autorë të panjohur*). Si rezultat i vetëm këtyre të gjeturave, Kolegji nuk mund ti pranoj pretendimet sipas të cilave është ardhur deri caktimi i gjyqtares së EULEX-it A.A.-G. në këtë rast apo përmbajtjes së bisedave para Gjykatës së Apelit. Vetëm për këtë arsye, pretendimet janë të pabazuara.

139. Duke dashur të qartësoj disa prej çështjeve ligjore të ngritura në kërkesa, atëherë Kolegji do të bëj disa vërejtje të përgjithshme lidhur me caktimin e gjyqtares së EULEX-it A.A.-G. në Kolegjin e Gjykatës Themelore. Argumenti kryesor i ngritur nga Mbrojtja është se nuk është ndjekur orari i brendshëm i EULEX-it dhe se për këtë arsye Kolegji i Gjykatës Themelore nuk ishte në përbërjen e paraparë me Nenin 384 (1.1) të KPP-së.

140. Kolegji pajtohet me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit se nuk ka pasur ndonjë skemë për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në kohën relevante. Sipas udhëzimit për caktimin e rasteve tek gjyqtarët e EULEX-it në rastet penale nëpër gjykatat e qarqeve”, e cila ka qenë e zbatueshme në kohën kur Gjyqtarja A.A.-G. u caktua në rast, nuk është mbështetur ndonjë orar specifik. Udhëzimi thjesht shpjegon strukturën e gjyqtarëve të EULEX-it në gjykata të qarqeve dhe i përshkruan parimet e përgjithshme të cilat zbatohen lidhur me caktimin e rastit. Po ashtu, Gjyqtarja A.A.-G. u caktua në rast sipas vendimit të datës 29 Maj 2014 të ushtruesit të detyrës së kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it, i cili aso kohe ka qenë i autorizuar për ta marr këtë vendim. Përveç kësaj, gjyqtarja e EULEX-it A.A.-G. aso kohe ka qenë e caktuar ligjërisht në nivelin e shkallës së parë.

141.  Gjykata Supreme nuk ka arsye për të besuar se paanshmëria e secilit prej gjyqtarëve është ndikuar në çfarëdo forme me rastin e marrjes së vendimit. Kolegji përfundon se nuk është paraqitur asnjë bazë për përjashtim.

142. Prandaj, Kolegji është i mendimit se as caktimi i Gjyqtares A.A.-G. nuk mund të cilësohet si shkelje e Nenit 384 (1.1) ose e Nenit 384 (1.2) e KPP-së. Kolegji vëren se edhe sikur të ketë pasur shkelje të rregullores së brendshme të EULEX-it (përderisa shkeljet e pretenduara nuk përbëjnë shkelje të ligjit përkatës – sikurse është kërkesa në fjalë se KPP-ja është shkelur), atëherë ajo do ishte një çështje e diskrecionit përbrenda

autoriteteve disiplinore/administrative të EULEX-it, sikurse veç është cekur sipër në paragrafin 121.

143. Dhe në fund, sa i përket pretendimit të Mbrojtjes e gjyqtarët e EULEX-it të cilët shërbejnë në Prishtinë mund të jenë vetëm gjyqtarë zëvendësues në Mitrovicë, Kolegji vëren se bile edhe sistemi ligjor vendor e njeh mundësinë e ri-caktimit të brendshëm të gjyqtarëve nëpër departamente të ndryshme, referuar Nenit 12 të Ligjit mbi Gjykatat (Nr. 03/L-199), i cili e rregullon organizimin e brendshëm të Gjykatave Themelore. Në pajtueshmëri me Nenin 12 (4) Kryetari i Gjykatës Themelore i cakton gjyqtarët nëpër departamente për të siguruar gjykim sa më efikas të rasteve dhe mundet të bëjë ri-caktime të përkohshme të gjyqtarëve nëpër degët dhe departamentet e gjykatave, varësisht nga nevoja dhe numri i rasteve apo për të siguruar vendosje të rasteve brenda afateve. Në rastin e gjyqtarëve të EULEX-it, ky ri-caktim bëhet nga ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe në nivel të Gjykatave themelore në mes të dy njësie ekzistuese, të ashtuquajturës njësia lëvizëse dhe njësia në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Kjo e fundit nuk bie në kontradiktë as me ligjin vendor mbi Gjykatat dhe as me “udhëzimin për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në rastet penale nëpër gjykatat e qarqeve”, i përmendur më sipër nën paragrafin 140.

144. Prandaj, Kolegji konkludon se nuk ka asnjë bazë për kërkesat e mbrojtjes së ligjshmërisë sipas Nenit 432 të KPP-së.

#### **Mungesa e regjistrimit me shkrim të procedurës**

145. Këshilltari mbrojtësi i S.S. pretendon se mungesa e regjistrimit fjalë për fjalë të shqyrtimit kryesor (ose në formë audio ose video-regjistrim) përbën shkelje të Nenit 315 të KPP-së.

146. Ky kolegji është i mendimit se nuk ka pasur kurrfarë shkeljesh të Nenit 315 të KPP-së. Neni 316 i KPP-së parasheh mundësinë e regjistrimit të gjykimit vetëm me shkrim, ashtu sikurse edhe është regjistruar nga Gjykata Themelore. Po ashtu, palët kanë të drejtë që gjithmonë ta kontrollojnë procesverbalin e shkruar dhe të kërkojnë përmirësime në pajtueshmëri me Nenin 316 (2) të KPP-së. Prandaj, ky kolegji nuk ka asnjë arsye për të

pranuar se mungesa e regjistrimit audio apo video ka shkelur në çfarëdo forme të drejtën e të pandehurit për një gjykim të drejtë.

### **Koncepti i dëshmitarit armiqësor**

147. Në këtë seksion Kolegji do të adresoj pretendimet lidhur me konceptin e dëshmitarit armiqësor gjatë shqyrtimit kryesor. Shkurtimisht, Mbrojtja deklaron se koncepti i dëshmitarit armiqësor nuk është i rregulluar me KPP dhe se përdorimi i këtij koncepti është në kundërshtim me KPP-në e gjithashtu edhe me parimin e barazisë mes palëve.
148. Kolegji pajtohet se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (pika 5). Është e pakontestueshme se KPP-ja nuk e njeh konceptin e dëshmitarit armiqësor si të tillë. Po ashtu në KPP nuk ka dispozita të zbatueshme për situatat në të cilat ndodh një ndryshim i plotë i deklaratave të dëshmitarit nën paragrafët 332-335 të KPP-së të cilët e rregullojnë marrjen në pyetje të dëshmitarit. Sidoqoftë, Kolegji vëren se sipas Nenit 123 (2) të KPP-së: "...Provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje mund të përdoren gjatë marrjes së tërthortë në pyetje për vënien në dyshim të dëshmitarëve nëse dëshmitari ka dëshmuar ndryshe nga dëshmia e dhënë gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake".
149. Duke e konsideruar dispozitën e sipër përmendur dhe detyrimin e përgjithshëm të Gjykatës për një vërtetim të plotë dhe të saktë të fakteve të cilat janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm (Neni 7 KPP) bashkë me detyrimin e Kryetarit të trupit gjykues i cili duhet të kujdeset për shqyrtimin e gjithanshëm dhe të drejtë të çështjes në pajtim me administrimin e provave siç parashihet me këtë Kod (Neni 299 (3) i KPP-së), Kolegji pajtohet se edhe sikur KPP-ja të mos e njeh në mënyrë eksplicite konceptin e dëshmitarit armiqësor, megjithatë e njeh një përafrim të tij i cili është i kodifikuar në ligjin e zbatueshëm procedural (Neni 123 (2) i KPP-së)
150. Prandaj, ky kolegji është i mendimit se Trupi gjykues i Gjykatës Themelore e ka kryer detyrën e vet për të vërtetuar në mënyrë të gjithanshme dhe të plotë faktet që kanë pasur rëndësi esenciale për marrjen e një vendimi të ligjshëm. Sipas Kolegjit, Gjyqtari kryesues - kur i bën pyetje dëshmitarëve gjatë shqyrtimit kryesor - nuk i ka tejkaluar kompetencat që ia njeh ligji kur e ka aplikuar konceptin e dëshmitarit armiqësor. Po ashtu, marrja në

pyetje e lejuar gjatë shqyrtimit kryesor - kur aplikohet koncepti i dëshmitarit armiqësor - nuk ka qenë në kundërshtim me ndalimet e parapara në Nenin 257 (4) të KPP-së. Prandaj, pretendimet në këtë pjesë janë të pabazuara.

#### **Përdorimi i deklaratave të marra në procedurë paraprake**

151. Mbrojtja pretendon, shkurtimisht, se deklaratat në procedurë paraprake të dëshmitarëve A, B, K dhe Dr. B.G. janë shtrembëruar, edituar rëndë dhe të përmbledhura keq dhe si të tilla nuk mund të përdoren për asnjë qëllim në Gjykatë pa e shkelur të drejtën e të pandehurit për një gjykim të paanshëm. Sipas pretendimeve të bëra nga Mbrojtja, për shkak të faktit se Gjykatat e shkallëve më të ulta i kanë përdorur këto deklaratat të dëshmitarëve në intervistat e procedurës paraprake dhe të cilat janë përshkruar në mënyrë të pasaktë nga vet dëshmitarët, atëherë të gjitha akuzat duhet të hidhen poshtë.

152. Kolegji vëren se Neni 123 (2) nuk e lejon trupin gjykues të përdor provat e siguruara gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake si prova direkte në shqyrtim kryesor. Kolegji është i mendimit se as Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe as Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk janë bazuar në deklaratat në procedurë paraprake në shkelje të Nenit të sipër përmendur. Gjithashtu, Kolegji pajtohet edhe me arsyetimin e dhënë në Aktgjykimet e shkallëve më të ulta lidhur me procesverbalet e përmbledhura në procedurë paraprake. Neni 131 (4) i KPP-së e lejon përmbledhjen e deklaratave të dhëna në procedurë paraprake.

153. Si përfundim, Kolegji është i mendimit se legjislacioni i zbatueshëm procedural lejon marrjen në pyetje në procedurë paraprake dhe përmbledhjen e atyre dëshmimeve. Po ashtu, pasaktësitë e pretenduara gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve A, B, K dhe Dr. B.G. nuk kanë pasur ndikim në rezultatin e dalur nga Gjykatat më të ulta pasi që deklaratat e pretenduara si të pasakta nuk janë përdorur si bazë për Aktgjykim e dhënë. Dhe si rrjedhojë, përdorimi i deklaratave në procedurë paraprake nuk ka rezultuar me shkeljen e të drejtës për një gjykim të drejtë.

#### **E drejta për një Gjykim të drejtë dhe pretendimi për shkelje të Kushtetutës**

154. Në këtë seksion Kolegji do të adresoj pretendimet lidhur me një gjykim të drejtë si parim i mbrojtur me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane të të drejtave të njeriut. Duke qenë se pretendimet lidhur me të drejtën e një gjykimi të drejtë janë adresuar pjesërisht më sipër në këtë Aktgjykim, Kolegji do ta përqendroj vëmendjen në pretendimin se shqyrtimi kryesor nuk është përmbyllur përbrenda një kohe të arsyeshme sipas Nenit 5 (1) të KPP-së.
155. Në pajtueshmëri me Nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një Gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj. Sipas Udhëzimit për Nenin 6 të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut<sup>5</sup>, arsyeshmëria lidhur me zgjatjen e procedurës duhet të përcaktohet sipas rrethanave të rastit, të cilat thërresin për një vlerësim të përgjithshëm. Neni 6 kërkon që procedura gjyqësore të jetë e shpejtë por gjithashtu e thekson edhe parimin e përgjithshëm të administrimit të saktë të drejtësisë. Në mes të aspekteve të shumta të këtij kriteri fundamental duhet të vendoset një bilans i drejtë (*Boddaert v. Belgium*, § 39).
156. Sipas Nenit 369 (1) të KPP-së, Aktgjykimi duhet të përpilohet me shkrim brenda 15 dite nga shpallja e tij, kur i akuzuari gjendet në paraburgim ose i është caktuar paraburgimi, ndërsa në rastet tjera brenda 30 ditësh nga dita e shpalljes së tij. Kur rasti është i ndërlikuar, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkoj nga presidenti i gjykatës që të zgjas afatin për përpilimin me shkrim të aktgjykimit deri në 60 ditë. Sipas Nenit 405 (2) të KPP-së, në qoftë se i akuzuari është në paraburgim, Gjykata e Apelit ia dërgon vendimin dhe shkresat gjykatës themelore jo më vonë se tre muaj nga dita e marrjes së shkresave nga kjo gjykatë.
157. Sidoqoftë, duke e pasur në konsideratë ndërlikueshmërinë e këtij rasti, seriozitetin e akuzave dhe numrin e të pandehurve të rastit, është e qartë se përfundimi i tekstit të aktgjykimit ka kërkuar një kohë të konsiderueshme.
158. Dhe në fund, Kolegji vëren se vonesa nuk e shkel Nenin 384 (1) të KPP-së. Po ashtu, as në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nuk përmendet se si kjo vonesë do ta ndikonte

---

<sup>5</sup> Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut, Udhëzuesi për Nenin 6 të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (2013), faqe 33

ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Prandaj, Kolegji gjen se lidhur me këtë pikë, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pabazuara.

#### **Përmbajtja e Aktgjyqimeve të shkruara (Neni 370 i KPP-së)**

159. Pretendimet e Mbrojtjes lidhur me përmbajtjen e aktgjyqimeve të shkruara përcaktojnë se dispozitivët e gjykatave më të ulta nuk i kanë plotësuar kriteret e vendosura në Nenet 370(3), 370(4) dhe 365 të KPP-së. Në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të F.D. dhe J.D., argumentohet veçanërisht se këto defekte në aktgjyqime përbëhen nga faktorët në vijim: mungesa e datës specifike e veprave të pretenduara penale nuk është e përmendur në dispozitiv, nuk është bërë asnjë përshkrim konkret për secilin nga veprimet kriminale të të pandehurve apo të pasojave të veprimeve të tyre dhe dispozitat ligjore me të cilat sanksionohen këto veprime penale nuk përmenden qartësisht.

160. Kolegji është i mendimit se dispozitivët e Gjykatave më të ulta i identifikojnë të pandehurit dhe veprimet e tyre kriminale për të cilat ata janë gjetur fajtorë. Data e akuzës I është e definuar duke deklaruar se ka ndodhur në datë të papërcaktuar të Shtatorit 1998 kurse për akuzën II deklarohet se ka ndodhur në disa data të papërcaktuara të Gushtit dhe Shtatorit 1998. Kolegji është i mendimit se koha është përcaktuar me një saktësi të arsyeshme.

161. Kolegji gjithashtu vëren se të pandehurit janë gjetur fajtorë për krimet që i kanë kryer në bashkë-kryerje. Prandaj të pandehurit mbahen përgjegjës dhe janë dënuar sikurse përshkruhet nga vet vepra penale. Si përfundim, pjesëmarrja e të pandehurve në krime është përshkruar saktësisht në aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit dhe se nuk ka nevojë që të specifikohet më tutje cilin veprim fizik (sikur për shembull të thuhet shkelmim në shpinë, shuplakë në fytyrë, goditje në kokë, etj) e ka kryer secili nga të pandehurit.

162. Në fund Kolegji vëren se në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit deklarohet në mënyrë eksplicite se cili ligj penal është zbatuar dhe gjithashtu jepen edhe arsyetime të hollësishme. Kolegji është i mendimit se nuk ka vend për gabime apo interpretime të

gabueshme për sa u përket Aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit.

163. Si përfundim, Kolegji deklaron se aktgjykimet e Gjykatave më të ulta i kanë plotësuar pre-rekuzitat e parapara me Nenet 370 (3), 370 (4) dhe 365 të KPP-së dhe se pretendimet e paraqitura janë të pabazuara.

### **Parimi i ligjshmërisë**

164. Në disa prej kërkesave për Mbrojtje të ligjshmërisë është përcaktuar se parimi i ligjshmërisë është shkelur nga Gjykatat më të ulta.

165. Sipas përkufizimit të parimit në fjalë të përmendur në Nenin 11 të Deklaratës Ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (1948) "*Askush nuk duhet të dënohet për veprime ose lëshime të cilat, në kohën kur janë kryer ato, nuk përbënin një veprë penale sipas ligjeve kombëtare a ndërkombëtare. Gjithashtu, nuk duhet të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka mundur të zbatohet në kohën kur është kryer vepra penale.*". Parimi i ligjshmërisë gjithashtu kodifikohet në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe në Kodin Penal të Kosovës (KPK).

166. Sa i përket çështjes së ligjit të zbatueshëm, Kolegji pajtohet plotësisht me përfundimin dhe arsyetimin e deklaruar në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (faqet 28 - 31). Dhe jo vetëm me vargun e dënimeve të aplikuar nga ligje të ndryshme por gjithashtu edhe me elementët që ndikojnë (për shembull bashkë-kryerja, vazhdimësia) në vlerësimin e ligjit më të favorshëm që duhet të merret në konsideratë kur bëhet vendosja për ligjin më të favorshëm.

167. Duke qenë se ky Kolegj ka gjetur se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj e ka korrigjuar saktë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, atëherë kërkesat për Mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me këtë pikë janë të pabazuara.

### **Shtrirja e akuzës**

168. Këshilltari mbrojtës i J.D. argumenton se dënimi e ka tejkaluar shtrirjen e akuzës. Këshilltari mbrojtës i referohet aktgjykimin të Gjykatës së Apelit (faqe 34 apo faqe 33 në



versionin anglisht) lidhur me përcaktimin e dënimeve dhe deklarohet se J.D. nuk është gjetur fajtor për urdhërimin e Dëshmitarëve A dhe B që ta rrihnin njëri tjetrin dhe se J.D. nuk ka qenë fajtor për rrahjen e tyre me shkop druri. Në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit nuk specifikohet se cilat vepra janë kryer nga i pandehuri, dhe cilat janë pasojat e atyre veprimeve të paligjishme dhe sipas cilave dispozita ligjore i pandehuri është mbajtur përgjegjës për këto veprime.

169. Kolegji i referohet pikave të mësipërme që adresojnë kufizimet e përcaktuara në Nenin 432 (2) të KPP-së lidhur me vlerësimin faktik. Kolegji gjithashtu i referohet atyre që janë deklaruar më parë në këtë Aktgjykim lidhur me përgjegjësinë penale të bashkë-kryesit.

170. Kolegji vëren se Neni 360 (1) i KPP-së thotë se aktgjykimi mund të referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës së përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor. Neni 360 (2) gjithashtu parasheh se Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës.

171. Duke qenë se të pandehurit janë dënuar për veprimet që kanë qenë objekt i akuzave të ngritura në Aktakuzë, Kolegji është i mendimit se shtrirja e akuzës nuk është tejkualuar. Vetëm me faktin se në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit - në kapitullin "përcaktimi i dënimeve" - listohen faktorët që kanë ndikuar në përcaktimin e dënimeve lidhur me secilin të pandehur, nuk tejkalohej shtrirjen e akuzës.

#### **Dëshmitari A si provë për përcaktimin e fajësisë (nenet 262 dhe 361 të KPP-së)**

172. Mbrojtja pretendon, në pika të shkurta, se dëshmia e dëshmitarit A ka qenë kontradiktore dhe thelbësisht e pambështetshme. Sipas pretendimeve të mbrojtjes, dëshmia e dëshmitarit A ishte kontradiktore dhe nuk mbështetej nga provat tjera dhe prandaj do duhej të ishte cilësuar si e papranueshme. Po ashtu, prova për përcaktimin e fajësisë bazohej vetëm në dëshminë e dëshmitarit A dhe prandaj përbënte shkelje të Nenet 262 të KPP-së.

173. Kolegji i referohet arsyetimit në pikën 125 lidhur me shtrirjen e gjyqimit të Kolegjit për sa i përket pretendimeve për besueshmërinë e Dëshmitarit A në përgjithësi. Sa i përket

pretendimit se dëshmia e Dëshmitarit A do duhej të ishte thelbësisht e pambështetshme sikurse përkufizohet në Nenin 19 (1.1.29) të KPP-së dhe si e tillë e papranueshme sipas Nenit 259 (2) të KPP-së, Kolegji është i mendimit se ky lloj vlerësimi në fakt nuk do ishte asgjë tjetër përpos se një vlerësim i ri lidhur me situatën faktike për sa i përket besueshmërisë së Dëshmitarit A. Për shkak të kufizimeve të parapara në Nenin 432 (2) të KPP-së, Kolegji nuk i vlerëson pretendimet që e kundërshtojnë vlerësimin faktik të bërë nga Gjykata Themelore dhe nga Gjykata e Apelit në rastin lidhur me kërkesat për Mbrojtje të ligjshmërisë.

174. Kolegji është i mendimit se kufizimet e përkufizuara në Nenin 262 të KPP-së nuk janë të zbatueshme për Dëshmitarin A. Dëshmitari A as nuk ka qenë anonim për Mbrojtjen dhe as nuk ka qenë në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues. Kolegji gjithashtu vëren se KPP-ja nuk i kufizon Gjykatat në bazimin e vlerësimit të tyre në dëshminë e vetëm një dëshmitari. Kjo përshkruhet edhe në Nenin 361 (1) të KPP-së se Gjykata duhet ta bazoj aktgjykimin e saj vetëm në faktet dhe provat e shqyrtuara në shqyrtimin gjyqësor. Dëshmia në fjalë është marr gjatë shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu, TNKLJ ka paraqitur në jurisprudencën e saj se dëshmia e dhënë nga një dëshmitar i vetëm lidhur me faktet materiale për sa i përket ligjit nuk ka nevojë të konfirmohet<sup>6</sup>. Prandaj dhe pa u futur në asnjë prej vlerësimeve faktike, Kolegji konkludon se duke iu referuar dëshmisë së Dëshmitarit A, as Gjykata Themelore dhe as ajo e Apelit nuk kanë shkelur asnjë prej dispozitave të Nenit 384 (1) të KPP-së.

175. Duke marr në konsideratë se ky Kolegj nuk e vlerëson rishtazi situatën faktike dhe arsyetimin e dhënë më sipër, Kolegji gjen se pretendimet në këtë pikë janë të pabazuara.

### KONKLUZIMET

Duke konsideruar sa u tha më sipër, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Me këto të dalura, Kolegji nuk gjen asnjë arsye për shtyer apo përfunduar ekzekutimin e aktgjykimeve.

---

<sup>6</sup> TNKLJ nr. IT-98-32-T me 29 Nëntor 2002 faqe 10 dhe TNKLJ nr. IT-03-66-T me 30 Nëntor 2005 faqe 9.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
PRISHTINË**

**PML.KZZ 322/2016, datë 19 korrik 2017**

**Gjyqtari kryesues dhe raportues:**

**Procesmbajtës:**

---

Elka Filcheva-Ermenkova  
Gjyqtare e EULEX-it

---

TimoTorkko  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

**Anëtarët e kolegjit:**

---

Arnout Louter  
Gjyqtare e EULEX-it

---

Nesrin Lushta  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme